



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastrë**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**

**Mbi Auditimin Financiar**

**Tiranë, shkurt 2026**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Faqe</b>
	Legjenda dhe shkurtime	3
<b>I</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>4-7</b>
a	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
b	Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij	4
c	Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe paraqitja e objektivave	4
d	Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave	4-5
e	Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve	5
f	Paraqitja e gjetjeve kryesore	5-6
g	Paraqitja e rekomandimeve kryesore	6
I.1	Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	7
<b>II</b>	<b>HYRJA</b>	<b>8-12</b>
1	Objektivat dhe qëllimi	8
2	Identifikimi i çështjes	8
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	8-9
4	Përgjegjësitë e audituesve	9
5	Kriteret e vlerësimit	9-10
6	Standardet e auditimit	10-11
7	Metoda e auditimit	11-12
8	Dokumentimi i auditimit	12
<b>III</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	<b>12-35</b>
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	12-13
2	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	13
2.1	Mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë.	13-19
2.2	Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë dhe bankë.	19-21
2.3	Mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e varësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurime shoqërore etj., ndaj buxhetit të shtetit. Inventarizimi i pronës publike.	21-35
<b>IV</b>	<b>REKOMANDIME</b>	<b>35-42</b>

## **Lista e shkurtimeve**

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NjAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
AShK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NjA	Njësi Administrative
ShA	Shoqëri Anonime
NjP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

## **I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE**

### **a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim:**

Shoqëria Aksionare “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastër është një shoqëri e regjistruar në QKB sipas Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*” i ndryshuar, që prej vitit 2005, nga ortaku Ministria e Ekonomisë dhe me VKM-në nr. 365, datë 06.05.2020, “*Për transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastër, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë tek Bashkia Gjirokastër*”, është vendosur transferimi i pronësisë së 100% të aksioneve të Shoqërisë, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë tek Bashkia Gjirokastër me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Burimet e financimit:

- a) *Të ardhurat e veta;*
- b) *Subvencioni nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;*

Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 30.10.2025, Shoqëria “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastër ka pasur disponibilitet fondesh në vlerën totale prej 55,945 mijë lekë, që vijnë në formën e të ardhurave të veta në vlerën 11,345 mijë lekë dhe subvencionim nga MAS në vlerën 44,600 mijë lekë. Planifikimi i shpenzimeve ka qenë në vlerën 67,381 mijë lekë ndërsa realizimi në vlerën 50,212 mijë lekë në masën 74.5% ose me një diferencë mosrealizimi në vlerën 17,168 mijë lekë.

### **b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij:**

Auditimi i Shoqërisë “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastër është thelbësor për të siguruar përdorimin e drejtë, efikas dhe transparent të fondeve publike. Ai ndihmon në verifikimin e ligjshmërisë së shpenzimeve, rrit përgjegjshmërinë e institucionit dhe parandalon keqmenaxhimin financiar. Përmes auditimit përmirësohet performanca institucionale, forcohet besimi i publikut dhe sigurohet që burimet financiare të përdoren për përmbushjen e objektivave të institucionit dhe interesit publik.

### **c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:**

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2024. Në këtë kontekst, qëllimi i auditimeve financiare është që të japë garanci dhe të rrisë nivelin e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korigjuese nga Shoqëria “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastër. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- a) Mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomiko-financiar të shoqërisë;
- b) Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë dhe bankë;
- c) Mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e varësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurime shoqërore etj., ndaj buxhetit të shtetit. Inventarizimi i pronës publike.

### **d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave:**

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë rrisi. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar. Nën

gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 0.7% për paga/sigurime shoqërore dhe shëndetësore dhe 0.7% për shpenzimet (*mallra dhe shërbime*). Për periudhën objekt auditimi, që auditohen pasqyrat financiare për vitin **2023** niveli i materialitetit pranohet në vlerën **338 mijë lekë** dhe gabimi i lejuar (10% - 20%) në vlerën 33 mijë lekë ndërsa për vitin **2024** niveli i materialitetit pranohet në vlerën **347 mijë lekë** dhe gabimi i lejuar (10% - 20%) në vlerën 34 mijë lekë, ku për t'u konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Mbi transaksionet u aplikuan: - teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (*u analizua menaxhimi financiar dhe kontrolli*). Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe shërbimeve, ku vlera e blerjes është e konsiderueshme. Metodot e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

**e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:** Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtiveve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar **11** gjetje dhe ka dhënë **12** rekomandime të karakterit organizativ.

## **2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.**

### **f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:**

*Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtiveve më poshtë:*

**1.** Me Urdhrin nr. 518, datë 29.12.2023, dhe Urdhrin nr. 904, datë 30.12.2024, të Administratorit të Shoqërisë, janë ngritur komisionet për inventarizimin e aktiveve të magazinës së institucionit respektivisht për vitet 2023 dhe 2024. Në urdhrat e përmendur më sipër nuk janë përfshirë për inventarizim fizik zërat "*Toka dhe ndërtesa*", "*Impiante dhe makineri*" dhe "*Të tjera instalime dhe pajisje*". Në këto kushte, llogaritë e pasqyrave financiare nuk janë të rakorduar me gjendjen fizike, gjë e cila nuk krijon besueshmëri mbi vërtetësinë e tyre. Në këtë rast, nxjerrja e pasqyrave financiare pa kryer inventarizimin fizik e të gjithë aseteve;

**2.** Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar më datë 31.12.2024, është kontabilizuar vlera prej 6,966,653 lekë si llogari të arkëtueshme. Shoqëria ka debitorë të pa mbledhur si ish-personel të ndërmarrjes të mbartur nga viti 2014, në bazë të akteve të kontrollit nga auditi i brendshëm si dëme financiare në vlerën 553,526 lekë; 2,824,020 lekë dhe 3,589,107 lekë të cilat ende nuk janë arkëtuar. Gjithashtu Shoqëria nuk disponohet një dokument për të cilën duhet të parashikonte riskun e mos arkëtimit nëpërmjet përlllogaritjes së provizioneve (*zhvlerësim*), në zbatim të SKK nr. 6, "*Provizionet, pasivet dhe aktivet e kushtëzuara*", pikat 10-11, i cili kërkon vlerësim individual për balancat e pa arkëtueshme në nivel individual si edhe në atë të përgjithshëm. Nga Shoqëria nuk është vendosur në dispozicion të grupit të auditimit një evidencë nëse ka ndjekur procedurat e mbledhjes së detyrimit pas proceseve gjyqësore të ndjekura;

**3.** Gjendja e Pasqyrës së Pozicionit Financiar "*Aktive Afatgjata Materiale*" më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 798,597,764 lekë e cila përbëhet nga zërat "*Toka dhe ndërtesa*" në vlerën 786,894,208 lekë, "*Impiante dhe makineri*" në vlerën 8,143,105 lekë dhe "*Të tjera instalime dhe pajisje*" në vlerën 3,560,452 lekë. Në Shënimet Shpjeguese për pasqyrave financiare të vitit 2024 citohet se: "*Në bilancin e vitit ushtrimor 2021, 2022, 2023 dhe 2024 nuk është paraqitur investimi që përfshin rikonstruksionin e godinës së Konviktit nr. 2. Investimi në formë donacioni nga A. T. "T." ka filluar në muajin Nëntor të vitit 2019, dhe përfundoi në muajin Qershor të vitit 2020. Në institucion nuk është paraqitur asnjë lloj dokumenti që njofton fillimin e rikonstruksionit, apo*

*dokumenta të tjera si: kontratë, dokument të marrjes në dorëzim të godinës së vjetër, situacion punimesh, fatura për vlerën e investimit, dokumenta për dorëzimin e këtij investimi të rikonstruktuar, vlera e pajisjeve, mobiljeve etj.*”. Në lidhje me këtë situatë u analizuan llogaritë e AAM-ve ku konstatohet se, Shoqëria nuk ka një regjistër analitik të asetëve me të dhënat specifike. Grupi i Auditimit konstatoi fizikisht që Godina e Konviktit është vendosur në restaurim dhe nga organet drejtuese deklarohen se kjo godinë e ka përfunduar restaurimin, por dokumenta justifikues si kontrata, vendime bordi, fatura tatimore, situacione apo punime në proces, akt të marrjes në dorëzim të aktivitet apo Vendime të Këshillit Mbikqyrës mbi këtë investim në godinë shoqëria nuk i disponon. Shoqëria nuk disponon ekspertizë apo akt dorëzimi me listë aktiveve përpara vendosjes në restaurim të godinës aktuale të shoqërisë e cila ka kryer punimet, të cilat mund të jenë hequr nga godina e vjetër. Gjithashtu nuk ka një listë aktiveve shoqëruar me inventar fizik dhe procesverbal në mbyllje të vitit ushtrimor 2024. Këto veprime janë në kundërshtim me SKK nr. 5, “Aktivet materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale” i përmirësuar, pikat 8-10;

**4.** Nga auditimi u konstatua se, Shoqëria “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastër gjatë hartimit të pasqyrave financiare ushtrimore për vitet 2023-2024 nuk ka kryer përditësimet respektive mbi aplikimin e normave të amortizimit sa i takon aktiveve afatgjata materiale, në zbatim të SKK nr. 5, “Aktivet materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale” i përmirësuar, pikat 33-38, dhe Ligjit nr. 156, datë 27.11.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar. Për më tepër aplikimi i normave të amortizimit është kryer pa marrë më parë, miratimin në Këshillin Mbikqyrës së Shoqërisë;

#### **g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:**

*Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:*

**1.** Administratori i Shoqërisë në bashkëpunim me Sektorin e Financës të marrin masa për mbylljen e procesit të inventarizimit të aktiveve të veta për zërat “*Toka dhe ndërtesa*”, “*Impiante dhe makineri*” dhe “*Të tjera instalime dhe pajisje*” duke bërë dhe verifikimin në terren të këtyre asetëve. Për diferencat eventuale të konstatuara dhe për vlerat jashtë përdorimit nga inventarizimi, të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe të procedohet sipas ligjit për sistemin e llogarive kontabël;

**2.** Administratori i Shoqërisë “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastër në bashkëpunim me Sektorin e Financës, të ndjek të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e debitorëve në vlerën 6,966,653 lekë, si dhe gjatë hartimit të pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore, të vlerësojë nëse ka evidenca të mjaftueshme objektive të zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe njohjet respektive në rezultatin ushtrimor;

**3.** Organet drejtuese të Shoqërisë t’i adresohen Asamblesë së Përgjithshme Aksionare (*Bashkia Gjirokastër*) për ngritjen e një grupi pune me specialist të fushën për verifikimin e dokumentacionit tekniko-ligjor në Zyrën e Arkivit të institucionit në lidhje me investimin e realizuar prej vitit 2019 nga A. T. (T.). Në rast se dosja teknike është adresuar dhe marrë në dorëzim nga Shoqëria por nuk disponohet si praktikë, të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit ndaj personave përgjegjës, në të kundërt (*në rast se dosja nuk është adresuar pranë institucionit*) t’i adresohet Ministrisë së Financave në rolin e ish-Asamblesë, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Asamblesë aktuale Bashkisë Gjirokastër për vendosjen në dispozicion të dosjes teknike me qëllim pasqyrimin e të gjithave zërave të punimeve të realizuara nga ky investim, duke i kontabilizuar ato në bilanc dhe paraqitjen e një shtese të drejtë të aktiveve afatgjata materiale;

**4.** Nga strukturat drejtuese të Shoqërisë të merren masa për aprovimin e normave menaxheriale, të mbështetura këto në studime dhe vlerësime për jetëgjatësinë e aktiveve afatgjata materiale nga specialistët e fushës brenda limiteve ligjore;

## **I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit:**

Bazuar në rezultatet e auditimit në Shoqërinë “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastër, KLSH-ja ka dhënë **“Opinion të modifikuar/kualifikuar me rezervë”** për pasqyrat financiare. Referuar gjetjeve të auditimit për përmirësimin e gjendjes janë dhënë rekomandimet përkatëse të klasifikuara në rekomandime të karakterit organizativ.

## **OPINIONI I AUDITIMIT**

### **I. Opinion mbi pasqyrat financiare për vitet 2023-2024:**

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastër për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2024, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

#### ***Opinionin:***

*Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, nga auditimi në pasqyrat financiare të Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastër për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2024, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionin të “modifikuar/kualifikuar, me rezervë”, e shprehur kjo në bazën për opinionin.*

#### **Bazat për opinionin e modifikuar/kualifikuar me rezervë:**

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “*Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*”, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 347 mijë lekë, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2024, si dhe anomalitë e mëposhtme:

- Për vitet 2023-2024 nuk është kryer inventarizimi për të gjithë Aktivet Afatgjata Materiale konkretisht zërat “*Toka dhe ndërtesa*”, “*Impiante dhe makineri*” dhe “*Të tjera instalime dhe pajisje*”. Në këto kushte, llogaritë e pasqyrave financiare nuk janë të rakorduar me gjendjen fizike, gjë e cila nuk krijon besueshmëri mbi vërtetësinë e tyre;

- Nuk është plotësuar regjistri i aktiveve që Shoqëria ka në pronësi apo posedim, me kërkesat minimale që duhet të përmbajë ky regjistër;

- Në gjendjen e AAM pjesë e Pasqyrës së Pozicionit Financiar nuk është përfshirë investimi i kryer nga A. T. (T.) që prej vitit 2019, për të cilin Shoqëria nuk disponon dosjen teknike;

- Për vitet 2023-2024 Shoqëria nuk ka kryer përditësimet respektive mbi aplikimin e normave të amortizimit sa i takon aktiveve afatgjata materiale, në zbatim të SKK nr. 5, “*Aktivet materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale*” i përmirësuar, pikat 33-38;

## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1042/1 prot., datë 03.11.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 04.11.2025 deri më datë 24.12.2025, në subjektin Shoqëria “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastër për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 01.10.2025, u krye auditimi “Mbi auditimin financiar”, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. M. H. (Përgjegjës grupi)
2. H. I., anëtar
3. A. G., anëtar

## OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIME DHE METODOLOGJIA

**1. Objektivat dhe qëllimi:** Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitet 2023-2024, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejtë dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të Shoqërisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar. Në përfundim të auditimit, hartohet Raporti Përfundimtar i Auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastër.

**2. Identifikimi i çështjes:** Përcaktimi i nivelit të duhur të materialitetit, për të mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t’i shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes. Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat. Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastër.

**3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:** Administratori i Shoqërisë në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Përgjegjësi i Sektorit të Financës në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet. Ministria e Arsimit dhe Sportit duke qenë së është institucioni buxhetor i

cili suvencionon me kuotë mujore një pjesë të shpenzimeve të Shoqërisë jep mendim mbi mënyrën e planifikimit të fondeve, ndërsa drafti përfundimtar ku konkludohet me Programin e Zhvillimit Ekonomik miratohet me vendim të veçantë nga Bashkia Gjirokastrë në rolin e Asamblesë së Përgjithshme Aksionare. Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

**4. Përgjegjësitë e audituesve:** Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Shoqërisë “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastrë dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit. Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësi të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit. Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si përkatësia, plotësia, saktësia dhe vlerësimi, periudha, klasifikimi dhe kuptueshmëria, ligjshmëria dhe rregullsia, ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi, transaksionet, të drejtat dhe detyrimet. Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Shoqërisë “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastrë është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH-së kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

**5. Kriteret e vlerësimit:** Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”;
- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*” i ndryshuar;
- Ligji nr. 8901, datë 23.05.2012, “*Për falimentimin*” i ndryshuar;
- Ligji nr. 25/2018, “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”;
- Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, “*Për kompetencat për caktimin e nivelit të pagave dhe shpërblimeve*” i ndryshuar;

- Ligji nr. 8487, datë 13.05.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës” i ndryshuar;
- Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve” i ndryshuar;
- Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994, “Për sponsorizimet” i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.2007, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”;
- VKM nr. 672, datë 26.10.2005, “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”;
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar;
- VKM nr. 642, datë 11.10.2005, “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore” i ndryshuar;
- VKM nr. 365, datë 06.05.2020, “Për transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastër, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë tek Bashkia Gjirokastër”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 15, datë 02.05.2018, “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetërore”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 7, datë 24.04.2003, “Për kriteret e planifikimit dhe përdorimit të subvencionit buxhetor në ndërmarrjet e trajtimit të studentëve dhe ndërmarrjet e konvikteve dhe mensave të studentëve”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 31, datë 23.12.2023, “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2023”;
- Udhëzimi nr. 13, datë 18.12.2024, “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2024”;
- Urdhri i Ministrit të Financave nr. 65, datë 05.05.2008, “Për shpalljen dhe zbatimin e detyrueshëm të Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar, të përkthyer në gjuhën shqipe”;
- Statuti i Shoqërisë i miratuar me shkresën nr. 5156 prot., datë 01.07.2020, të Asamblesë së Përgjithshme Aksionare.

## **6. Standardet e auditimit:**

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;
- ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”;
- INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;

- ISSAI 400 “*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*”;
- ISSAI 4200 “*Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë*”;
- INTOSAI “*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*” etj.;
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm etj.;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.;
- Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

**7. Metoda e auditimit:** Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin<sup>1</sup>:*

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

*Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:*

*1. Kontrolli aritmetik:*

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*);

*2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese:*

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar;

---

<sup>1</sup> ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

### 3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese:

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj.,. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt;

### 4. Kontrolli i vlerësimit:

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre;

### 5. Konfirmim nga të tretët:

Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër;

### 6. Kontrolli sipas një treguesi:

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.,.

- Verifikimi i transaksioneve është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- Intervistimi është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- Raporte dhe informacione janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

**8. Dokumentimi i auditimit:** Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të Përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, mbi Akt-Konstatimin e mbajtur, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Projekt Raporti dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit. Nga Shoqëria “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastër nuk u paraqitën observacione mbi aktkonstatimet.

## **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

**1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin Shoqëria “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastër.** Shoqëria “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastës ka si objekt aktiviteti, trajtimin e studentëve të Universitetit “*Eqerem Çabej*” Gjirokastër me akomodim dhe shërbime të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi duke kryer çdo operacion tregtar dhe financiar të nevojshëm, që lidhet drejtëpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj. Për ofrimin e këtij shërbimi Shoqëria organizohet dhe funksionon në dy ndarje në Konviktin e Vajzave dhe atë të Djemve. Konvikti nr. 1, në të cilën akomodohej studentët vajza organizohet dhe funksionon i ndarë në pesë godina me sipërfaqe bazë 1,005 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe totale e godinave 4,631 m<sup>2</sup> me kapacitet akomodues 27 dhoma funksionale dhe numër maksimal akomodimi shtetësh për 165 studentë. Konvikti nr. 2, në të cilën

akomodohen studentët djemt organizohet dhe funksionon me një godinë, me sipërfaqe bazë 961 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe totale e godinave 3,210 m<sup>2</sup> me kapacitet akomodues 51 dhoma funksionale dhe numër maksimal akomodimi shtretësh për 127 studentë.

Të ardhurat që arkëtohen nga akomodimi i studentëve kanë një rënie të ndjeshme nga viti në vit si pasojë e mos aplikimit të këtij shërbimi nga studentët konkretisht:

a) Për vitin akademik 2022-2023 numri i studentëve të akomoduar është 122, arkëtimet janë në vlerën 5,020,650 lekë;

b) Për vitin akademik 2023-2024 numri i studentëve të akomoduar është 93, arkëtimet janë në vlerën 3,735,000 lekë;

c) Për vitin akademik 2024-2025 numri i studentëve të akomoduar është 71, arkëtimet janë në vlerën 2,589,449 lekë.

Për periudhën e audituar peshën kryesore për realizimin e shpenzimeve e ka zëri “Paga dhe Sigurime” në vlerën 32,104 mijë lekë dhe zëri “Mallra dhe Shërbime” në vlerën 18,108 mijë lekë, për sa i përket “Investimeve” janë planifikuar në vlerën 7,320 mijë lekë por të pa realizuara. Aktualisht struktura organizative e Shoqërisë përbëhet nga 14 punonjës.

## **2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.**

### **2.1. Mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë.**

#### **2.1.1. Organizimi dhe funksionimi, disponibiliteti i kapaciteteve të Konvikteve të Shoqërisë:**

Shoqëria “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastër për trajtimin e studentëve të Universitetit “*Eqerem Çabej*” Gjirokastër me akomodim dhe shërbime të tjera, disponon në pronësi dy Konvikte konkretisht:

##### *a. Të dhëna të përgjithshme për Konviktin nr. 1, (Vajzat):*

Konvikti nr. 1, në të cilën akomodohen studentët vajza organizohet dhe funksionon i ndarë në pesë godina me sipërfaqe bazë 1,005 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe totale e godinave 4,631 m<sup>2</sup>, ku për herë të fundit është rikonstruktuar që prej vitit 2014. Godinat ndahen në këtë formë:

- Godina A, përbëhet nga 7 kate, me kapacitet akomodues 15 dhoma funksionale dhe numër maksimal akomodimi shtretësh për 60 studentë. Në dispozicion të studentëve si pjesë përbërëse e kësaj godine është edhe mensa e konviktit e cila ndodhet jashtë funksionit;

- Godina B, përbëhet nga 9 kate, me kapacitet akomodues 0 dhoma funksionale dhe numër maksimal akomodimi shtretësh për 32 studentë;

- Godina C, përbëhet nga 7 kate, me kapacitet akomodues 10 dhoma funksionale dhe numër maksimal akomodimi shtretësh për 42 studentë;

- Godina D, përbëhet nga 3 kate, me kapacitet akomodues 0 dhoma funksionale dhe numër maksimal akomodimi shtretësh për 27 studentë;

- Godina E, përbëhet nga 4 kate, me kapacitet akomodues 2 dhoma funksionale dhe numër maksimal akomodimi shtretësh për 4 studentë.

*Terrenet Sportive:* Në posedim dhe administrim të konviktit ndodhet një terren sportiv për lojrat me dorë të llojit voleyboll.

*Gjendja aktuale e godinave:* Duke marrë në konsideratë faktin që investimet për përmirësimin e gjendjes infrastrukturore të godinave ka datuar që prej vitit 2014, godinat kanë filluar të amortizohen duke paraqitur problematikë në: suvatimin e mureve; sistemin elektrik; dyert; dritaret; sistemin sanitar (*Tualetet*) për më tepër që disponohet nga një i vetëm në secilin kat.

*Sistemi i ngrohjes së godinave:* Ngruhja e godinave kryehet jo me sistem qendror ngrohje dhe për vendosjes në funksion përdoret energji elektrike.

*Ofrimi i shërbimeve:* Gjatë ushtrimit të aktivitetit evidentohen problematika të mbartura ndër vite të cilat ndikojnë direkt apo tërthorazi mbi ofrimin e shërbimeve ndaj studentëve si në aspektin social por edhe në mënyrën e jetesës në konvikt konkretisht nuk disponohet: sallë biblioteke apo

studimi; nyje WC për personat me aftësi të kufizuara; rampë me pjerrësi jo më të madhe se 5% për akses të personave me aftësi të kufizuara; sistem të plotë ndriçimi elektrik të jashtëm; sistem tokëzimi; sistem sigurie (*alarmi*); sistem njoftimi zanor nga zjarri; dalje emergjente/evakuimi në të gjitha katet e godinës; sistem impianti me ujë të ngrohtë funksional; impiant i shkarkimit të ujrave të bardha të shiut.

*b. Të dhëna të përgjithshme për Konviktin nr. 2, (Djemt):*

Konvikti nr. 2, në të cilën akomodohen studentët djemt organizohet dhe funksionon me një godinë, me sipërfaqe bazë 961 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe totale e godinave 3,210 m<sup>2</sup>, ku për herë të fundit është rikonstruktuar që prej vitit 2021. Godina organizohet në këtë formë:

- Godina A, përbëhet nga 4 kate, me kapacitet akomodues 51 dhoma funksionale dhe numër maksimal akomodimi shtretësh për 127 studentë.

*Terrenet Sportive:* Në posedim dhe administrim të konviktit nuk ndodhet ambient sportiv, por ofrohet një terren sportiv në afërsi të tij.

*Gjendja aktuale e godinave:* Duke marrë në konsideratë faktin që investimet për përmirësimin e gjendjes infrastrukturore të godinave ka datuar që prej vitit 2021, godina është mjaft funksionale përveç problematikës të hidroizolimit të tarracës/çatisë. Gjithashtu evidentohet e njëjta problematikë me atë të konviktit nr. 1, sistemi sanitar (*Tualetet*) disponohet nga një i vetëm në secilin kat.

*Sistemi i ngrohjes së godinave:* Ngrohja e godinave kryehet jo me sistem qendror ngrohje dhe për vendosjes në funksion përdoret energji elektrike.

*Ofrimi i shërbimeve:* Gjatë ushtrimit të aktivitetit evidentohen problematika të mbartura ndër vite të cilat ndikojnë direkt apo tërthorazi mbi ofrimin e shërbimeve ndaj studentëve si në aspektin social por edhe në mënyrën e jetesës në konvikt konkretisht nuk disponohet: sallë biblioteke apo studimi; nyje WC për personat me aftësi të kufizuara; rampë me pjerrësi jo më të madhe se 5% për akses të personave me aftësi të kufizuara dhe impiant i shkarkimit të ujrave të bardha të shiut.

**2.1.2. Dispozitat ligjore për hartimin e programit ekonomik-financiar:**

Për hartimin e programit ekonomik-financiare janë aplikuar dispozitat ligjore si më poshtë:

- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, neni 1, citohet se: “Ky ligj rregullon statusin e tregtarit, themelimin dhe administrimin e shoqërive tregtare, të drejtat dhe detyrimet e themeluesve, të ortakëve dhe aksionarëve, riorganizimin dhe likuidimin e shoqërive tregtare. Shoqëritë tregtare janë shoqëritë kolektive, shoqëritë komandite, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe shoqëritë aksionare”;

- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, gërma “dh”, citohet se: “miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu edhe numrin maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë”;

- VKM-ja nr. 317, datë 08.07.1998, i ndryshuar me VKM-në nr. 52, datë 16.01.2008, “Për shpërblimin e punës së punonjësve”, pikat 2-3, pika 7, pika 9, citohet se: “Pika 2. Me “ndërmarrje shtetërore” kuptohet ndërmarrja me kapital 100 për qind shtetëror, që funksionon sipas Ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992, “Për shoqëritë tregtare”, ndërmarrja që funksionon sipas Ligjit nr. 7582, datë 13.07.1992, “Për ndërmarrjet shtetërore”, si dhe institucioni shtetërore, banka, INSIG-u, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Instituti i Sigurimeve Shëndetësore.

Pika 3. Ndërmarrjet i caktojnë pagat e punës vetë, në varësi të mundësisë financiare që kanë, sipas programit të zhvillimit, të miratuar nga organet përkatëse. Në fillim të çdo viti ndërmarrjet bëjnë indeksimin e pagave deri në masën dhe në afatin e përcaktuar me vendimin e Këshillit të Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare, pasi të sigurojnë rezervat, që përcaktohen në dispozitat ligjore, dhe të mos rezultojnë me humbje.

Pika 7. Punonjësit e ndërmarrjeve, që funksionojnë sipas Ligjit nr. 7582, datë 13.07.1992, “Për ndërmarrjet shtetërore”, përfitojnë shërbim suplementar jo më shumë se 15 për qind të fitimit të realizuar, vetëm kur ndërmarrjet e kanë rezervën përkatëse, por jo më shumë se dy paga mujore në vit për secilin prej tyre.

Pika 9. Për ndërmarrjet, veprimtaria e të cilave është me humbje dhe subvencionohet nga shteti (jo për diferencën e çmimeve), ministritë shqyrtojnë programin financiar të tyre dhe caktojnë fondin e pagave për periudhën përkatëse”;

- VKM-ja nr. 75, datë 12.02.2018, “Për miratimin e modelit të financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor”, Kapitulli V “Dispozita të fundit”, pika 2, citohet se: “Fondet e buxhetit të shtetit, të miratuara në formë transferte për “Shoqëritë e trajtimit të studentëve”, SHA., në Tiranë dhe në rrethe, paguhen në llogarinë bankare të përfituesit nga struktura përgjegjëse për thesarin, me urdhër të njësisë së qeverisjes së përgjithshme dhënëse dhe me paraqitjen nga kjo e fundit të dokumenteve justifikuese të shpenzimit (situacion, fatura, listëpagesa etj.)”;

- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 15, datë 02.05.2018, “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetërore”, Kapitulli I, pika 6, Kapitulli III, pika 3, citohet se: “Pika 6. Për shoqëritë strategjike, portet dhe shoqëritë që subvencionohen nga ministritë e linjës administrative, pas miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës do të kërkohet mendimi i ministrive përkatëse. Projekt programi i shoqëruar me vendimin e këshillit mbikëqyrës dhe pranon çmimin e ministrisë së linjës administrative do të përcillet për miratim përfundimtar në Ministrinë përgjegjëse për ekonominë”.

Pika 3. Ministritë që përfaqësojnë linjën administrative të shoqërive strategjike, portet dhe shoqëritë që subvencionohen nga këto ministri, pasi i shqyrtojnë programet e zhvillimit, formulojnë qëndrimet përkatëse për treguesit kryesorë, brenda datës 30 janar të çdo viti”;

- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 7, datë 24.04.2003, “Për kriteret e planifikimit dhe përdorimit të subvencionit buxhetor në ndërmarrjet e trajtimit të studentëve dhe ndërmarrjet e konvikteve dhe mensave të studentëve”, pika 1, citohet se: “Shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore, llogariten në bazë të pikave 7 dhe 9 të VKM nr. 317, datë 08.07.1998, “Për shpërblimin e punës së punonjësve” duke patur parasysht: Numrin e punonjësve të llogaritur sipas pasqyrës së mëposhtme:

Ndërmarrja	Normativa (Studentë për punonjës)
NTS1 Tiranë dhe NKM Elbasan	Jo më pak se 15 punonjës
NTS2 Tiranë	Jo më pak se 12 punonjës
NTS3 Tiranë	Jo më pak se 10 punonjës
NKM Gjirokastrë, Vlorë, Shkodër, Korçë	Jo më pak se 11 punonjës

- Mundësitë ekonomike financiare të çdo ndërmarrje.

- Rruajtjen e një Kufiri të pages mesatare për punonjës jo më shumë se 20,000 lekë në muaj.

- Shpenzime për sigurimet shoqërore të përcaktohen sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Shpenzimet e tjera si për energji elektrike, prodhim avulli, lëndë djegëse dhe blerje mallrash të ndryshme dhe shërbimesh të tjera të llogariten mbi bazën e normativave në lekë për studentët në vit sipas tabelës së mëposhtme:

Ndërmarrja	Normativa (Studentë për punonjës)
NTS1, NTS2, NTS3, Tiranë Tiranë dhe NKM Elbasan	Jo më shumë se 25,000
NKM Gjirokastrë, Vlorë, Shkodër, Korçë	Jo më shumë se 24,000

- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, nenet 191-194, citohet se:

“Pika 191. Kalimi i shumës së subvencionit në llogarinë bankare të përfituesit kryhet nga struktura përgjegjëse për thesarin me urdhër të njësisë së qeverisjes së përgjithshme dhënëse dhe me paraqitjen nga kjo e fundit të dokumenteve justifikuese të shpenzimit (situacion, fatura, listëpagesa etj.) në zbatim të procedurave përkatëse.

Pika 192. Dhënia e kështit të parë të subvencionit bëhet sipas planit në formë paradhënie, ndërsa në rastet e tjera dhënia e subvencionit bëhet sipas situacionit, jo më shumë se plani, duke zbritur diferencën e situacionit të periudhës së mëparshme. Në asnjë rast subvencioni nuk jepet me tepër nga plani. Kur situacioni i periudhës së mëparshme paraqitet me tejkalim, ai nuk merret parasysh.

Pika 193. Njësia e qeverisjes së përgjithshme dhënëse e subvencionit, përveç situacionit, kërkon edhe një kopje të dokumenteve justifikuese bashkëlidhur me të.

Pika 194. Njësia e qeverisjes së përgjithshme dhënëse e subvencionit ka detyrim të ushtrojë kontroll dhe të kërkojë ekspertim për situacionet dhe dokumentacionin përkatës. Në rast të kundërt, njësia e qeverisjes së përgjithshme dhënëse bën pezullimin e dhënies së fondeve të reja për subvencionin”.

### 2.1.3. Treguesit mbi realizimin e kapaciteteve akomoduese për trajtimin e studentëve:

- Me shkresën nr. 56 prot., datë 15.01.2025, nga Shoqëria është hartuar Raporti Përmbledhës mbi listën e studentëve për vitin akademik 2023-2024, ku totali i akomodimit shkon **93** studentë:

#### Konvikti 1 + 2

a) Studente vajza  $25 + 35 = 60$

b) Stundetë djem  $5 + 16 = 21$

c) Praktikantë  $6 + 6 = 12$

#### **Totali 93 Studentë**

- Me shkresën nr. 1014 prot., datë 17.10.2025, nga Shoqëria është hartuar Raporti Përmbledhës mbi listën e studentëve për vitin akademik 2024-2025, ku totali i akomodimit shkon **71** studentë:

#### Konvikti 1 + 2

a) Studente vajza  $20 + 37 = 57$

b) Stundetë djem  $5 + 8 = 13$

c) Praktikantë  $1 = 1$

#### **Totali 71 Studentë**

Për rakordimin e numrit të strukturës në përpjestim me numrin e studentëve të akomoduar në konvikte, janë shqyrtuar vendimet e Këshillit Mbikëqyrës si më poshtë:

- Me Vendimin nr. 1, datë 17.02.2023, Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar strukturën organizative dhe nivelin e pagave të shoqërisë për vitin 2023 me një total prej 18 punonjës nga të cilët 4 punonjës të jashtëm me kontratë;

- Me Vendimin nr. 19, datë 29.12.2023, Këshilli i Mbikëqyrës ka miratuar strukturën organizative dhe nivelin e pagave të shoqërisë për vitin 2024 me një total prej 18 punonjës nga të cilët 4 punonjës të jashtëm me kontratë;

- Me Vendimin nr. 14, datë 16.09.2024, Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar strukturën organizative dhe nivelin e pagave të shoqërisë për vitin 2024 me një total prej 14;

- Nga auditimi u konstatua se, struktura organike nuk është përcaktuar saktë në zbatim të Udhëzimit nr. 7, datë 24.04.2003, “Për kriteret e planifikimit dhe përdorimit të subvencionit buxhetor në ndërmarrjet e trajtimit të studentëve dhe ndërmarrjet e konvikteve dhe mensave të studentëve”, pika 1, ku cilësohet se raporti i strukturës duhet të jetë 1 punonjës për 11 studentë, konkretisht:

Shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore, llogariten në bazë të pikave 7 dhe 9 të VKM nr. 317, datë 08.07.1998 “Për shpërblimin e punës së punonjësve” duke patur parasysh: - Numrin e punonjësve të llogaritur sipas pasqyrës së mëposhtme:	
<b>Ndërmarrja</b>	<b>Normativa (Studentë për punonjës)</b>
NTS1 Tiranë dhe NKM Elbasan	Jo më pak se 15 punonjës
NTS2 Tiranë	Jo më pak se 12 punonjës
NTS3 Tiranë	Jo më pak se 10 punonjës
<b>NKM Gjirokastrë, Vlorë, Shkodër, Korçë</b>	<b>Jo më pak se 11 punonjës</b>

- Mundësitë ekonomike financiare të çdo ndërmarrje.

- Rruajtjen e një Kufiri të pages mesatare për punonjës jo më shumë se 20,000 lekë në muaj.  
- Shpenzime për sigurimet shoqërore të përcaktohen sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Nga komunikimet verbale me strukturat drejtuese të Shoqërisë, lidhur me konstatimin e sipërpërmendur janë ngritur pretendimet se është e pamundur të respektohen kuotat punonjës për studentë referuar Udhëzimit nr. 7, datë 24.04.2003, *“Për kriteret e planifikimit dhe përdorimit të subvencionit buxhetor në ndërmarrjet e trajtimit të studentëve dhe ndërmarrjet e konvikteve dhe mensave të studentëve”* për arsyet e mëposhtme:

- Pamjaftueshmëria e likuiditeteve ndër vite.

Në shkresat mujore të alokimit të fondeve nga Ministria e Arsimit dhe Sportit citohet që shoqëritë do të subvencionohen në zbatim të VKM-së nr. 75, datë 12.02.2018, fondet e buxhetit të shtetit të miratuara në formë transferte për Shoqëritë të Trajtimit të Studentëve, kryen me urdhër të njësisë së qeverisjes së përgjithshme dhënëse me paraqitjen e dokumenteve justifikuese të shpenzimeve (*situacion, fatura, listëpagesa etj.*). Subvencionimi i Shoqërisë *“Trajtimi i Studentëve”* Gjirokastër nuk është kryer mbi bazën e dokumenteve justifikuese të dërguara bashkëlidhur me situacionet mujore, por referuar kriterëve të parashikuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 7, datë 24.04.2003, duke krijuar gjithmonë *“ngërçin”* për subvencionimin e përvitshëm. Për këtë arsye ndër vite janë krijuar detyrime të prapambetura.

- Udhëzimi i lartpërmendur, ka dalë në zbatim të Ligjit nr. 8983, datë 20.12.2002, *“Për buxhetin e shtetit të vitit 2003”* dhe Udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2003, *“Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2003”* të cilat janë shfuqizuar;

- Udhëzimi është miratuar kur Trajtimet e Studenteve në vitin 2003, ishin institucione Ndërmarrje Shtetërore, ndërsa Shoqëri Aksionare është krijuar vitin 2005;

- Nuk përshtatet me kushtet aktuale të zhvillimit ekonomik - financiar të vendit;

- Nuk përshtatet me ndryshimet e çmimeve (*të cilat kanë përsuar një ndryshim total që prej vitit 2003, në të cilin është miratuar udhëzimi*);

- Nuk përshtatet me Paktin e Universiteteve, Vendimit nr. 75, datë 12.02.2018, *“Për miratimin e modelit të financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor”*;

- Nuk përshtatet me mënyrën dhe organizimin e punëve në Shoqëritë e Trajtimit të Studentëve;

- Shërbimi që ofrojnë këto Shoqëri janë me përgjegjësi të lartë ndaj studentëve në plotësimin e kushteve të jetesës por dhe kujdesit ndaj tyre në çdo aspekt brenda territorit të Shoqërisë;

- Konvikti organizohet me tre turne në të cilën çdo turn ka strukturën sipas pozicioneve, përgjegjësi dhe nevojave. Për këtë arsye, stafi/punonjësit aktual është i organizuar dhe i përshtatur me 3 turne sipas Kodit të Punës;

- Ministria e Arsimit për tre vitet e fundit ka shprehur rezerva mbi programin ekonomik të zhvillimit, duke sugjeruar reduktimin e punonjësve të institucionit.

**Konkluzion:** Grupi i Auditimit nga analiza e përmendur më sipër konstaton se, udhëzimi bie ndesh me mënyrën e organizimit real të punës, qëllimit kryesor të veprimtarisë në shërbim të akomodimit, të sigurisë e përgjegjësisë që ka Shoqëria ndaj studentëve dhe prindërve për fëmijë përgjatë 24 orëve të ditës, në lidhje me përcaktimin e numrit të punonjësve për student.

**2.1.4. Hapat e ndjekura nga Shoqëria për hartimin dhe miratimin e programit ekonomik zhvillimor:**

**Burimet e financimit:**

a) Të ardhura e veta;

b) Subvencioni nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;

Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 30.10.2025, Shoqëria *“Trajtimi i Studentëve”* Gjirokastër ka pasur disponibilitet fondesh në vlerën totale prej 55,945,099 lekë e përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 11,345,099 lekë dhe subvencion në vlerën 44,600,000 lekë. Shpërndarja e tyre ndër vite paraqitet si më poshtë:

Lekë					
Të Ardhurat		2023	2024	Janar - Tetor 2025	Totali
		1	Të ardhurat e veta	5,020,650	3,735,000
2	Subvencioni	13,100,000	18,000,000	13,500,000	44,600,000
		<b>18,120,650</b>	<b>21,735,000</b>	<b>16,089,449</b>	<b>55,945,099</b>

**Tabela nr. 1.** Burimet e Financimit për vitet 2023-Tetor 2025.

Grupi i auditimit ka kryer një analizë të detajuar mbi realizimin e të ardhurave për pesë vitet e fundit, me qëllim evidentimin e trendit zbritës të akomodimit të numrit të studentëve:

Lekë				
Viti	Nr. i të akomoduarve	Të ardhura nga akomodimet		Subvencione
2021	125	3,084,800		10,375,000
2022	126	4,608,818		8,759,020
2023	151	5,020,650		13,100,000
2024	172	3,735,000		18,000,000
2025	71	2,589,449		13,500,000
<b>Totali</b>	<b>645</b>	<b>19,038,717</b>		<b>63,734,020</b>

**Tabela nr. 2.** Analiza dhe trendi mbi realizimin e të ardhurave dhe numrin e akomodimeve të studentëve për pesë vitet e fundit.

Lekë			
Studentë	Viti akademik 2022-2023	Viti akademik 2023-2024	Viti akademik 2024-2025
Numri	122	93	71

**Tabela nr. 3.** Realizimi i kapaciteteve akomoduese për vitet 2023-2025.

Vlen të theksohet që të ardhurat të cilat arkëtohen nga akomodimi i studentëve kanë një rënie të ndjeshme nga viti në vit, duke shkaktuar një gap financiar për mbulimin e të gjitha shpenzimeve operative dhe investimeve. Mungesa e të ardhurave çon në mos realizim e mirëmbajtjes së godinave të konviteve apo kryerjen e shërbimeve të caktuara me qëllim kthimin në gjendjen me kapacitet funksional dhe kushte optimale për akomodimin e studentëve.

Për sa i përket subvencionit që vjen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk shpërndahet në referencë të dokumentacionit justifikues të paraqitur nga Shoqëria (*kërkesa për disponibilitet fondesh*) në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Kreu III “Subvencionet”, pikat 191-194, por në formën e një kuote mujore për përballimin e pagave dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Referuar kthim përgjigjeve të mbi programin ekonomik zhvillimor, Ministria e Arsimit dhe Sportit shpreh rezerva për mos plotësimin me fondet e kërkuara nga Shoqëria, duke e sygjyer reduktimin e numrit të punonjësve, me qëllim krijimin e fondeve për të mbuluar shpenzimet operative apo investimet. Gjithashtu lidhur për reduktimin e numrin të punonjësve MAS bazohet në përcaktimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 7, datë 24.04.2003.

**Konkluzion:** Në lidhje me këtë situatë grupi i auditimit ka arritur në konkluzionin se, për hartimin e programeve ekonomike zhvillimore nuk ka një bazë ligjore të mirë përcaktuar/konsoliduar, gjithë përfshirëse me elementët plotësues që duhet të ketë një program ekonomik.

Për sa i përket Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 15, datë 02.05.2018, “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, është një dispozitë ligjore e cila është aplikuar nga Shoqëritë e Trajtimit të Studentëve përgjatë fazës ku në rolin e Asamblesë së Përgjithshme Aksionare ka qenë Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe jo Bashkitë.

Duke marrë në konsideratë faktin që numri i akomodimit të studentëve në konviktet e Shoqërisë ka një trend në rënie nga viti në vit, dhe e vetmja mënyrë që ky institucion të mos jetë në pamjaftueshmëri ekonomike si dhe të shmang humbjen, është mbulimi me kapacitet të plotë financiar në formën e subvencionit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Bashkia Gjirokastrë, me qëllim realizimin e shërbimit me të gjithë parametrat dhe kushtet që duhet të ketë Shoqëria “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastrë.

## Realizimi i burimeve ekonomiko financiare:

Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 30.10.2025, planifikimi i shpenzimeve është në vlerën 67,381,442 lekë dhe realizimi në vlerën 50,212,849 lekë në masën 74.5% ose me një diferencë mosrealizimi në vlerën 17,168,593 lekë e ndarë kjo:

- Për vitin 2023 planifikimi i shpenzimeve është në vlerën 21,670,600 lekë dhe realizuar në vlerën 16,903,097 lekë në masën 78% ose me një diferencë mosrealizimi në vlerën 4,767,503 lekë e përbërë nga zëri “Paga dhe sigurime” në vlerën 11,947,252 lekë dhe zëri “Shpenzime operative” në vlerën 4,955,844 lekë.

- Për vitin 2024 planifikimi i shpenzimeve është në vlerën 23,443,135 lekë dhe realizuar në vlerën 17,374,147 lekë në masën 74.1% ose me një diferencë mosrealizimi në vlerën 6,068,988 lekë e përbërë nga zëri “Paga dhe sigurime” në vlerën 11,211,914 lekë dhe zëri “Shpenzime operative” në vlerën 6,162,233 lekë.

- Për periudhën Janar-Tetor 2025 planifikimi i shpenzimeve është në vlerën 22,267,707 lekë dhe realizuar në vlerën 15,935,605 lekë në masën 71.5% ose me një diferencë mosrealizimi në vlerën 6,332,102 lekë e përbërë nga zëri “Paga dhe sigurime” në vlerën 8,945,270 lekë dhe zëri “Shpenzime operative” në vlerën 6,990,335 lekë.

Të dhënat në mënyrë të përmbledhur mbi realizimin e shpenzimeve për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 30.10.2025, paraqiten si më poshtë:

Lekë						
Nr.	Shpenzimet	Plani 2023	Rishikuar	Realizimi 2023	Realizimi në %	Diferenca
1	Paga + Sigurime	10,308,000	0	11,947,252	116	(1,639,252)
2	Shpenzimet operative	9,642,600	0	4,955,844	51	4,686,756
3	Investimet	1,720,000	0	0	0	1,720,000
<b>Totali</b>		<b>21,670,600</b>	<b>0</b>	<b>16,903,097</b>	<b>78</b>	<b>4,767,503</b>
Nr.	Shpenzimet	Plani 2024	Rishikuar	Realizimi 2024	Realizimi në %	Diferenca
1	Paga + Sigurime	12,506,000	10,323,000	11,211,914	108.6	(888,914)
2	Shpenzimet operative	9,236,05	9,870,135	6,162,233	62.4	3,707,902
3	Investimet	3,750,000	3,250,000	0	0	3,250,000
<b>Totali</b>		<b>25,492,050</b>	<b>23,443,135</b>	<b>17,374,147</b>	<b>74.1</b>	<b>6,068,988</b>
Nr.	Shpenzimet	Plani 2025	Rishikuar	Realizimi 2025	Realizimi në %	Diferenca
1	Paga + Sigurime	13,884,966	13,184,766	8,945,270	67.8	4,239,496
2	Shpenzimet operative	9,532,940	9,082,940	6,990,335	76.9	2,092,605
3	Investimet	1,850,000	0	0	0	0
<b>Totali</b>		<b>25,267,906</b>	<b>22,267,706</b>	<b>15,935,605</b>	<b>71.5</b>	<b>6,332,101</b>

Tabela nr. 4. Planifikimi dhe realizimi i treguesve të Programit Ekonomiko Financiar për vitet 2023-Tetor 2025.

Programet ekonomiko-financiare (*buxhetet vjetore*) janë hartuar dhe realizuar në pamjaftueshmëri financiar pasi aktiviteti i shoqërisë nuk është i mbuluar në fakt plotësisht me buxhet duke marrë në konsideratë faktin që Shoqëria ka humbje të mbartur për tre vitet e fundit 2022 në vlerën 52,425,637 lekë; 2023 në vlerën 57,038,690 lekë dhe 2024 në vlerën 56,548,228 lekë, duke mos realizuar investimet dhe shpenzimet operative të parashikuara ndër vite për mirëmbajtjen e godina të konviteve duke krijuar risk të mund për nxjerrjen jashtë funksionit të tyre për shkak të amortizimit të lartë. Për më tepër evidentohet devijim i fondeve nga zëri “Shpenzime operative” në zërat “Paga + Sigurime” si pasojë e mos realizimit të plotë të të ardhurave të veta si dhe mos mbulimit me subvencion nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Bashkia Gjirokastrë. Gjithashtu për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 30.10.2025, programet ekonomike-financiare zhvillimore janë miratuar vetëm nga Këshilli Mbikëqyrës por jo nga Asambleja Aksionare (Bashkia Gjirokastrë). Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, gërma “dh” dhe Statutin e Shoqërisë.

## 2.2. Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë dhe bankë.

Gjatë aktivitetit të vet Shoqëria “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastrë ka kryer veprimet ekonomike dhe financiare të cilat në përgjithësi janë regjistruar në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë

08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar. Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve me bankë u konstatua se, në përgjithësi dokumentacioni i bankës është i plotë i sistemuar, urdhër pagesat janë të shoqëruara me dokumentacionin vërtetues dhe justifikues/argumentues. Veprime financiare janë kontabilizuar në ditarët e hyrjeve dhe daljeve të llogarisë bankare, sipas kërkesave të kontabilitetit. Çdo muaj është bërë kuadrimi i ditarit të bankës dhe urdhër pagesat janë pasqyruar drejt nëpër llogaritë sintetike dhe analitike, sipas natyrës së shpenzimit, duke vepruar konform me kuadrin rregullator në fuqi. Referuar auditimit të ditarëve të bankës Shoqëria “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastër kryen transaksione financiare nëpërmjet bankave R. B. dhe A. B. Pagesat në përgjithësi janë kryer nëpërmjet kërkesave për transaksionet në bankat përkatëse ku dokumenti është i konfirmuar nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues. Bashkëlidhur listë pagesave janë listë prezencat mujore sipas Sektorëve, urdhrat e Administratorit të Shoqërisë për emërimet dhe largimet nga puna, raportet mjekësore etj.. Gjendja e bankave në fillim dhe në fund të vitit për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 30.10.2025, pasqyrohet në mënyrë të hollësishme në tabelën si më poshtë:

	Lekë			
Çelje	A. B.	R. B.	Mbyllje	
Çelje më datë 01.01.2023	1,194,009.60	1,310,607.01	2,504,616.61	
Mbyllje më datë 31.12.2023	468,620.96	2,922,238.92	3,390,859.88	
Çelje më datë 01.01.2024	2,922,238.92	468,620.96	3,390,859.88	
Mbyllje më datë 31.12.2024	998,107.01	6,561,197.68	7,559,304.69	
Çelje më datë 01.01.2025	998,107.01	6,561,197.68	7,559,304.69	
Mbyllje më datë 30.10.2025	839,980.99	6,873,219.04	7,713,200.03	

**Tabela nr. 5.** Të dhënat mbi gjendjen e bankave në fillim dhe në fund të vitit, për vitet 2023-Tetor 2025.

	Lekë			
Nr.	Kategoria e shpenzimeve	31.12.2023	31.12.2024	30.10.2025
1	Paga, Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore, tatim në burim	12,810,094	12,167,348	9,722,713
2	Ujë, Energji dhe taksa tarifa vendore	3,423,486	3,726,374	3,284,106
3	Shërbime, mallra, shpenzime operative	669,517	1,480,426	2,928,786
<b>Totali</b>		<b>16,903,097</b>	<b>17,374,148</b>	<b>15,935,605</b>

**Tabela nr. 6.** Të dhënat në mënyrë të përmbledhur mbi veprimet e kryera me bankë sipas zërave përkatës për vitet 2023-Tetor 2025.

Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 30.10.2025, Shoqëria “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastër ka kryer shpenzime në vlerën totale prej 50,212,850 lekë, nga të cilat peshën specifike e zënë zërat “*Pagat, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore, Tatimi në Burim*” në vlerën 34,700,155 lekë në masën 69.1%, “*Pagesat mbi konsumin e ujit, energjisë elektrike dhe taksave dhe tarifave vendore*” në vlerën 10,433,966 lekë në masën 27.3% dhe “*Shërbime, mallra, shpenzime operative*” në vlerën 5,078,729 lekë në masën 10.1%.

Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera me bankë u konstatua se, për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.10.2025, Shoqëria “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastër ka shpenzuar vlerën totale prej **671,114 lekë** (sipas likujdime pjesore mujore) që i përkasin objektit “*Shpenzimeve Honorare*”.

- Me shkresën nr. 553 prot., datë 09.10.2024, z. I. M. Administrator i Shoqërisë është drejtuar Këshillit Mbikëqyrës me një relacion lidhur me nevojat emergjente të institucionit për marrjen në punë me kontratë shërbimi të punonjësve të jashtëm. Në këtë relacion citohet se: “*Kryerja e shërbimit në pozicionin sanitare është i nevojshëm për të përballuar ngarkesën e punës në këtë godinë për shkak për arsye sepse hapsira e madhe e godinës bën të pamundur mbarëvajtjen e punës dhe shpesh herë khasim në ankesa nga studentët*”.

Me Vendimin nr. 16, datë 09.10.2024, të Këshillit Mbikëqyrës me objekt “*Marrjen në punë të punonjësve me kontratë shërbimi*”. Për realizimin e këtij shërbimi sipas nevojës ndërmjet Shoqërisë dhe znj. B. K. është nënshkruar kontrata e shërbimit me nr. 568 prot., datë 09.10.2024, me afat një mujor e cila rinovohet sipas kërkesave të institucionit.

- Me shkresën nr. 853 prot., datë 19.12.2024, z. I. M. Administrator i Shoqërisë është drejtuar Këshillit Mbikëqyrës me një relacion lidhur me nevojat emergjente të institucionit për marrjen në punë me kontratë shërbimi të punonjësve të jashtëm. Në këtë relacion citohet se: *“Marrjen në punë me kontratë shërbimi të një punonjësi të jashtëm duke e trajtuar atë në bazë të pagesë minimale në shkallë vendi dhe orëve të punës me pagesë honoritike. Kryerja e shërbimit në pozicionin “Kujdestar” është i nevojshëm për të përballuar ngarkesën e punës në godinën e konviktit nr. 2, për shkak sepse numri i të akomoduarve në godinë ka ardhë në rritje duke përfshirë disa kategori si: studentë, të punësuar, futbollistë etj.,. Përfshirja e disa kategorive në këtë godinë bën të pamundur mbarëvajtjen e punës dhe ofrimin e kushteve më të mira të studentëve, për këtë arsye është i nevojë emergjente punësimi kujdestar”*.

Me Vendimin nr. 21, datë 19.12.2024, të Këshillit Mbikëqyrës me objekt *“Marrjen në punë të punonjësve me kontratë shërbimi”*. Për realizimin e këtij shërbimi sipas nevojës ndërmjet Shoqërisë dhe znj. M. L. është nënshkruar kontrata e shërbimit me nr. 732 prot., datë 28.07.2025, me afat një muaj e cila rinovohet sipas kërkesave të institucionit. Nga auditimi i kësaj praktike u konstatua se, ky shpenzim nuk i përket “Shpenzimeve Honorare” por një kontratë shërbimi dhe në këto kushte duhej t’i nënshtrohej rregullave të prokurimit publik. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar, nenet 7-9, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, neni 8. Aplikimi i kësaj ka ardhur si rezultat për mos tejkalimin e numrit të punonjësve për studentë.

### **2.3. Mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e varësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurime shoqërore etj., ndaj buxhetit të shtetit. Inventarizimi i pronës publike.**

#### **2.3.1. Organizimi dhe funksionimi i Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastër:**

Shoqëria Aksionare *“Trajtimi i Studentëve”* Gjirokastër është një shoqëri e regjistruar në QKB sipas Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”* i ndryshuar, që prej vitit 2005, nga ortaku Ministria e Ekonomisë dhe me VKM-në nr. 365, datë 06.05.2020, *“Për transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastër, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë tek Bashkia Gjirokastër”*, është vendosur transferimi i pronësisë së 100% të aksioneve të Shoqërisë, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë tek Bashkia Gjirokastër me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Nga verifikimi në faqen zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare, VKM-ja e sipërpërmendur ka hyrë në fuqi, pasi është botuar në Fletoren Zyrtare me nr. 84, datë 11.05.2020, me objekt aktiviteti trajtimi i studentëve të Universitetit *“Eqerem Çabej”* Gjirokastër me akomodim dhe shërbime të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi duke kryer çdo operacion tregtar dhe financiar të nevojshëm, që lidhet drejtëpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj.

Organet drejtuese të Shoqërisë sipas Statutit të miratuar me shkresën nr. 5156 prot., datë 01.07.2020, nga Aksioneri i vetëm i Shoqërisë, Bashkia Gjirokastër e përfaqësuar nga Kryetari z. F. G. janë:

- Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë (*Ortaku i vetëm*);
- Administratori/ët e Shoqërisë;
- Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë;

Këshilli Mbikëqyrës për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 30.10.2025, ka funksionuar duke u bazuar në legjislacionin: Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”* i ndryshuar; Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, *“Tatimi mbi të ardhurat”* i ndryshuar; VKM-në nr.

642, datë 11.10.2005, “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore” i ndryshuar; Statuti i Shoqërisë etj., Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë ka në përbërje të saj një kryetar, dy anëtarë dhe një sekretar të këshillit. Përbërja e Këshillit për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.10.2025, kanë qenë: kryetarë znj. J. M., z. N. N., anëtarë znj. N. Sh., znj. A. Ll., znj. M. I. dhe sekretar znj. A. M., sipas vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të evidentuara si më poshtë:

- Me Vendimin nr. 12, datë 01.09.2023, të Aksionarit është liruar nga detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës znj. N. Sh. dhe në vend të saj emërimin e znj. A. Ll.;
- Me Vendimin nr. 8, datë 17.05.2024, të Aksionarit është liruar nga detyra e kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës znj. J. M.;
- Me Vendimin nr. 9, datë 17.05.2024, të Aksionarit është emëruar kryetar i Këshillit Mbikëqyrës z. N. N.;

Këshilli Mbikëqyrës me Vendimin nr. 346, datë 27.12.2018, ka miratuar Rregulloren e Brendshme dhe Kodin Etik të Shoqërisë. Rregullorja mbi funksionimin dhe organizimin e institucionit është përditësuar në muajin dhjetor të vitit 2024 sipas shkresës me nr. 936 prot., datë 30.12.2024, pasi struktura e Shoqërisë ka pasur ndryshime ndër vite.

- Me Vendimin nr. 1, datë 17.02.2023, Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar strukturën organizative dhe nivelin e pagave të shoqërisë për vitin 2023 me një total prej 18 punonjës nga të cilët 4 punonjës të jashtëm me kontratë;

- Me Vendimin nr. 19, datë 29.12.2023, Këshilli i Mbikëqyrës ka miratuar strukturën organizative dhe nivelin e pagave të shoqërisë për vitin 2024 me një total prej 18 punonjës nga të cilët 4 punonjës të jashtëm me kontratë;

- Me Vendimin nr. 14, datë 16.09.2024, Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar strukturën organizative dhe nivelin e pagave të shoqërisë për vitin 2024 me një total prej 14;

- Struktura organizative dhe niveli i pagave të Shoqërisë “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastër për periudhën objekt auditimi, nuk është miratuar specifikisht nga Asambleja e Përgjithshme Aksionare. Organet drejtuese të Shoqërisë (*Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori*) e kanë quajtur të ezauruar miratimin vetëm me miratimin e programin ekonomik ku pjesë e tij është edhe fondi i pagave. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 35/2023, datë 25.05.2023, “*Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitime të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi*”, neni 6, ku përcaktohet që:

*Në Republikën e Shqipërisë kanë kompetencë për caktimin e pagës, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve, sipas përkatësisë:*

*a) Kuvendi;*

*b) Këshilli i Ministrave;*

*c) këshillat e njësisve të vetëqeverisjes vendore;*

*ç) organet kolegjiale drejtuese të njësisve të fondeve speciale;*

*d) organet kolegjiale drejtuese të ndërmarrjeve shtetërore me kapital mbi 50 për qind shtetëror;*

*dh) organet kolegjiale drejtuese të institucioneve të pavarura apo të institucioneve të administratës shtetërore, në rastet kur këto institucione financohen pjesërisht apo tërësisht nga fonde të tjera, të ndryshme nga ato të buxhetit të shtetit, dhe kur kjo kompetencë është përcaktuar shprehimisht në ligjin e krijimit, organizimit dhe funksionimit të tyre.*

Administratorë të Shoqërisë për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 30.10.2025, kanë qenë: z. B. K., z. B. K., z. I. M. dhe z. I. M. sipas vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të cituara si më poshtë:

- Me Vendimin nr. 26, datë 20.03.2023, të Aksionarit është liruar nga detyra e Administratorit të Shoqërisë z. B. K.;
- Me Vendimin nr. 27, datë 20.03.2023, të Aksionarit është emëruar Administrator i Shoqërisë z. B. K.;

- Me Vendimin nr. 7, datë 14.07.2023, të Aksionarit është liruar nga detyra e Administratorit të Shoqërisë z. B. K.;
  - Me Vendimin nr. 9, datë 14.07.2023, të Aksionarit është emëruar Administrator i Shoqërisë z. I. M.;
  - Me Vendimin nr. 18, datë 10.12.2024, të Aksionarit është liruar nga detyra e Administratorit të Shoqërisë z. I. M.;
  - Me Vendimin nr. 19, datë 11.12.2024, të Aksionarit është emëruar Administrator i Shoqërisë z. I. M.;
- Për periudhën objekt auditimi në pozicionin e Administratorit të Shoqërisë “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastër kanë qenë katër administratorë konkretisht: z. B. K., z. B. K., z. I. M. dhe z. I. M. të emëruar në këtë detyrë sipas vendimeve respektive të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë me nr. 26-27, datë 20.03.2023, nr. 7, nr. 9, datë 14.07.2023, nr. 18, datë 10.12.2024, dhe nr. 19, datë 11.12.2025.

Nga auditimi u konstatua se, për të katër Administratorët nuk është lidhur kontratë individuale pune me Këshillin Mbikëqyrës. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të një keq interpretimi të Statutit të Shoqërisë duke e konsideruar të ezauruar faktin e kontratës së punës nëpërmjet aktit të emërimit të administratorit, nga Asambledhja e Përgjithshme Aksionare. Këto veprime janë në kundërshtim me Statutin e Shoqërisë të miratuar me shkresën nr. 5156 prot., datë 01.07.2020, neni 6 “*Emërimi i Administratorëve*”, pika 1, ku përcaktohet që:

*Pika 1: Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizikë si administratorë të Shoqërisë për një periudhë tre vjeçare bazuar, në shkronjën “c”, të pikës 2, të nenit 135, në nenin 158 dhe në pikën 2, të nenit 167, të Ligjit. Emërimi i administratorëve bëhet me akt individual emërimi pasi të jetë bërë miratimi me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë në çdo kohë administratorët nga detyra, pa cënuar të drejtat që burojnë nga një kontratë pune e lidhur me Shoqërinë.*

### **2.3.2. Mbajtja e evidencës kontabile:**

Përgatitja dhe paraqitja e pasqyrave financiare është bërë përgjithësisht në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*” i ndryshuar, dhe Statutit të Shoqërisë.

Organizimi i kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, është bërë përgjithësisht sipas Ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”; Ligjit nr. 10926, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar, Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*” i ndryshuar; VKM-së nr. 672, datë 26.10.2005, “*Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit*” dhe Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 65, datë 05.05.2008, “*Për shpalljen dhe zbatimin e detyrueshëm të Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar, të përkthyer në gjuhën shqipe*”.

Ato janë përgatitur në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 2, “*Paraqitja e pasqyrave financiare*”, veprimet e kryera dokumentohen dhe regjistrohen në librat e kontabilitetit në përputhje me parimet e SKK-ve. Regjistrat janë të mbajtur në gjuhën shqipe dhe vlerat në njësinë monetare Shqiptare në lekë. Veprimet në valutë janë konvertuar në lekë sipas standardit kontabël përkatës. Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të kostos historike, duke kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimi i të drejtave të konstatuara. Regjistrimet kontabël janë të pajisur me evidencë mbështetëse që sigurojnë besueshmërinë e tyre. U konstatua se regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e llogarisë kontabël, bëhet duke u bazuar në dokumentacionin përkatës kontabël.

#### **✓ Për vitin 2023:**

Pasqyrat financiare të vitit 2023 dhe Shënimet Shpjeguese të Shoqërisë “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastër janë përgatitur dhe nënshkruar nga z. I. M. Administrator i Shoqërisë në cilësinë e NA

dhe znj. R. G. Përgjegjës i Financës në cilësinë e NP, duke u shoqëruar edhe me Raportin e Audituesve të Pavarur znj. R. A. me nr. 4.. Liçense dhe znj. M. Xh. me nr. 1... Liçense, të cilat kanë marrë miratimin nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë me Vendimin nr. 11, datë 10.06.2024. Me shkresën nr. 263 prot., datë 10.06.2024, të administruar në Bashkinë Gjirokastrë me praktikën nr. 19 prot., datë 10.06.2024, janë dërguar pasqyrat financiare të vitit 2023 për miratimin nga Asambleja e Përgjithshme Aksionare.

Me Vendimin nr. 12, datë 10.06.2024, të Asamblesë së Përgjithshme Aksionare është miratuar:

- *Pasqyrat Financiare të vitit 2023 të Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastër dhe fitimin e ushtrimit 580,462 lekë;*

- *Destinimi i fitimit të ushtrimit prej 580,462 lekë, të kalohet në rezervë ligjore;*

✓ **Për vitin 2024:**

Pasqyrat financiare të vitit 2024 dhe Shënimet Shpjeguese të Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastër janë përgatitur dhe nënshkruar nga z. I. M. Administrator i Shoqërisë në cilësinë e NA dhe znj. R. G. Përgjegjës i Financës në cilësinë e NP, duke u shoqëruar edhe me Raportin e Audituesve të Pavarur znj. R. A. me nr. 4.. Liçense dhe znj. M. Xh. me nr. 1.. Liçense, të cilat kanë marrë miratimin nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë me Vendimin nr. 13, datë 30.06.2024.

Me shkresën nr. 631 prot., datë 30.06.2024, të administruar në Bashkinë Gjirokastrë me praktikën nr. 24 prot., datë 30.06.2024, janë dërguar pasqyrat financiare të vitit 2024 për miratimin nga Asambleja e Përgjithshme Aksionare.

Me Vendimin nr. 14, datë 30.06.2024, të Asamblesë së Përgjithshme Aksionare ka miratuar:

- *Pasqyrat Financiare të vitit 2024 të Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastër dhe fitimin e ushtrimit 4,260,000 lekë;*

- *Destinimi i fitimit të ushtrimit prej 4,260,000 lekë, të kalohet në rezervë ligjore;*

Nga auditimi u konstatua se, pasqyrat financiare për vitet 2023-2024, nuk janë depozituar pranë Degës së Thesarit Gjirokastrë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 31, datë 23.12.2023, “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2023”, pika 35, dhe Udhëzimin nr. 13, datë 18.12.2024, “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2024”, pika 13, ku përcaktohet që:

*Pika 35. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme me vetëfinancim hartojnë pasqyrat financiare vjetore sipas formatit të miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë (pika 33 e këtij udhëzimi) në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë (e cila vë në dispozicion të dhënave elektronike ekzistuese në SIFQ deri në fund të muajit Janar të vitit 2024). Të dhënat përfundimtare të pasqyrave financiare vjetore 2023 paraqiten brenda muajit Mars të vitit 2024, në strukturën përgjegjëse për thesarin në degë dhe në strukturën përgjegjëse për statistikat pranë INSTAT-it.*

*Pika 13. Në zbatim të Udhëzimit nr. 37, datë 06.10.2020, “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, të dhënat e detyrimeve të prapambetura (vlera e stokut, e paguar dhe krijuar rishtazi), për njësitë e qeverisjes së përgjithshme me vetëfinancim, regjistrohen në SIFQ brenda muajit Janar të vitit 2025 dhe rakordon brenda datës 10 Shkurt 2025 midis njësitë të qeverisjes së përgjithshme me vetëfinancim dhe degëve të thesarit, të cilat menjëherë raportojnë përkatësisht në strukturën përgjegjëse për thesarin pranë ministrisë përgjegjëse për financat sipas formatit të raportit të gjeneruar nga SIFQ për publikim paraprak më datë 14.02.2025, dhe përfundimtar më datë 28.02.2025.*

○ **Procesi i inventarizimit:**

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, neni 74, parashikohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

- Nga auditimi u konstatua se, Shoqëria “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastrë nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat minimale që duhet të përmbajë ky

regjistër. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 30, ku përcaktohet që:

*Pika 30. “Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia”.*

- **Për vitin 2023:** Me Urdhrin nr. 518, datë 29.12.2023, të z. I. M. Administrator i Shoqërisë është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve të mallrave të magazinës së institucionit i përbërë nga znj. G. P. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. A. R. dhe z. B. B. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit komisioni ka hartuar Raportin Përmbledhës me shkresën nr. 519 prot., datë 29.12.2023.

- **Për vitin 2024:** Me Urdhrin nr. 904, datë 30.12.2024, të z. I. M. Administrator i Shoqërisë është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve të mallrave të magazinës së institucionit i përbërë nga znj. A. R. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. V. M. dhe z. A. D.. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit komisioni ka hartuar Raportin Përmbledhës me shkresën nr. 907 prot., datë 31.12.2024.

Për më tepër në urdhrat e mësipër mbi realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit për vitet 2023-2024, nuk janë përfshirë për inventarizim fizik zërat “*Toka dhe ndërtesa*”, “*Impiante dhe makineri*” dhe “*Të tjera instalime dhe pajisje*”. Në këtë rast nxjerrja e pasygrave financiare pa kryer inventarizimin fizik të të gjithë aktiveve, është shkelje e kërkesave të Udhëzimit nr. 30, datë 31.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 74.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të peirudhave raportuese për vitet 2023-2024, të Pozicionit Financiar të Shoqërisë “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastër paraqitet në pasqyrat financiare të mëposhtme. Nga procesi i auditimit mbi referenca e llogarive të Aktivitetit dhe të Detyrimeve, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore për vitet 2023-2024, të saktësisë dhe bezueshmërisë së tyre paraqitet si më poshtë:

<b>PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>Lekë 2024</b>
<b>AKTIVET</b>			
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
<b>Mjete monetare</b>	2,504,617	3,390,860	7,559,305
<b>Investime</b>			
<i>Në tituj pronësie të njërive ekonomike brenda grupit</i>			
<i>Në tituj pronësie të njërive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>			
<i>Aksione të veta</i>			
<i>Të tjera financiare</i>			
<b>Të drejta të arkëtueshme</b>			
<i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>		345,000	536,000
<i>Nga njësitë ekonomike brenda grupit</i>			
<i>Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>			
<i>Të tjera</i>	7,013,153	6,966,653	6,966,653
<i>Kapital i nënshkruar i papaguar</i>			
<b>Inventarët</b>			
<i>Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme</i>	582,394	305,514	532,518
<i>Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte</i>			
<i>Produkte të gatshme</i>			
<i>Mallra</i>			

<i>Aktive biologjike (gjë e gjallë në rritje dhe majmeri)</i>			
<i>AAGjM të mbajtura për shitje</i>			
<i>Parapagime për inventar</i>			
<b>Shpenzime të shtyra</b>		1,750	
<b>Të arkëtueshme nga të ardhura të konstatuara</b>			
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>	<b>10,100,164</b>	<b>11,009,777</b>	<b>15,594,476</b>
<b>Aktive afatgjata</b>			
<b>Aktive financiare</b>			
<i>Tituj pronësie të njësive ekonomike brenda grupit</i>			
<i>Tituj pronësie të njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>			
<i>Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit</i>			
<i>Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>			
<i>Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata</i>			
<i>Tituj të tjerë të huadhënies</i>			
<b>Aktive materiale</b>			
<i>Toka dhe ndërtesa</i>	788,470,360	787,681,889	786,894,208
<i>Impiante dhe makineri</i>	9,022,830	8,571,689	8,143,105
<i>Të tjera instalime dhe pajisje</i>	3,945,099	3,747,845	3,560,452
<i>AAGjM të mbajtura për investim</i>			
<i>Parapagime për aktive materiale dhe në proces</i>			
<b>Aktivitet biologjike</b>			
<b>Aktive jo materiale</b>			
<i>Konçensionime, patenta, liçensa, makra tregtare, të drejta dhe aktive të ngjashme</i>			
<i>Emri i mirë</i>			
<i>Parapagime për AAJM</i>			
<b>Aktivitet tatimore të shtyra</b>			
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>	<b>801,438,289</b>	<b>800,001,423</b>	<b>798,597,764</b>
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>	<b>811,538,453</b>	<b>811,011,200</b>	<b>814,192,240</b>
<b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
<i>Titujt e huamarrjes</i>			
<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>			
<i>Aktetime në avance për porosi</i>			
<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>	2,023,496	1,681,031	1,297,357
<i>Dëftesa të pagueshme</i>			
<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit</i>			
<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>			
<i>Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore</i>	875,874	238,964	322,870
<i>Të pagueshme për detyrime tatimore</i>	27,864	26,174	74,065
<i>Të tjera të pagueshme</i>	684,396	557,746	338,090
<b>Të pagueshme për shpenzime të konstatuara</b>			
<b>Të ardhura të shtyra</b>			
<b>Provizione</b>			
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>	<b>3,611,630</b>	<b>2,503,915</b>	<b>2,032,382</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
<i>Titujt e huamarrjes</i>			
<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>			
<i>Aktetime në avancë për porosi</i>			
<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>			
<i>Dëftesa të pagueshme</i>			
<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit</i>			
<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>			

<i>Të tjera të pagueshme</i>	31,892,876	31,892,876	31,285,449
<b>Të pagueshme për shpenzime të konstatuara</b>			
<b>Të ardhura të shtyra</b>			
<b>Provizione</b>			
<i>Provizione për pensione</i>			
<i>Provizione të tjera</i>			
<b>Detyrime tatimore të shtyra</b>			
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>	<b>31,892,876</b>	<b>31,892,876</b>	<b>31,285,449</b>
<b>Detyrime totale</b>	<b>35,504,506</b>	<b>34,396,791</b>	<b>33,317,831</b>
<b>Kapitali dhe Rezervat</b>			
<b>Kapitali i nënshkruar</b>	727,244,000	727,244,000	727,244,000
<b>Primi i lidhur me kapitalin</b>			
<b>Rezerva rivlerësimi</b>			
<b>Rezerva të tjera</b>			
<i>Rezerva ligjore</i>			
<i>Rezerva statutoe</i>			
<i>Rezerva të tjera</i>	105,828,637	105,828,637	105,828,637
<i>Diferenca nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja</i>			
<b>Fitimi/(humbja) e pashpërndarë</b>	(52,425,637)	(57,038,690)	(56,458,228)
<b>Fitimi/(humbja) e periudhës</b>	(4,613,053)	580,462	4,260,000
<b>Totali i kapitalit që i takon pronarëve njësisë ekonomike</b>	<b>776,033,947</b>	<b>776,614,409</b>	<b>780,874,409</b>
Interesa jo-kontrollues			
<b>Totali i kapitalit</b>	<b>776,033,947</b>	<b>776,614,409</b>	<b>780,874,409</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>	<b>811,538,453</b>	<b>811,011,200</b>	<b>814,192,240</b>

## AKTIVET

### Aktivitet Afatshkurtra përbëhen nga:

- **Mjete monetare** më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 3,390,860 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 7,559,305 lekë me një rritje në vlerën 4,168,445 lekë.

Shoqëria “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastër kryer transaksione vetëm nëpërmjet bankës dhe nuk vepron me arkë. Në postin “*Mjete monetare*” gjendja e bankave kuadron me gjendjen e mbylljes në pasqyrat financiare për vitet 2023-2024. Shoqëria operon nëpërmjet dy bankave të nivelit të dytë R. B. dhe A. B. Veprimet rakorduese në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqiten si më poshtë:

- ✓ A. B. 998,107.01 lekë;
- ✓ R. B. 6,561,197.68 lekë;

**Totali 7,559,304.69 lekë**

### Të drejta të arkëtueshme përbëhen nga:

- **Nga aktiviteti i shfrytëzimit** më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 345,000 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 536,000 lekë me një rritje në vlerën 191,000 lekë.

Në analizën e zërit “*Nga aktiviteti i shfrytëzimit*” përfshihen debitorët në mbylljen e vitit ushtrimor 2024 si më poshtë:

- ✓ Akademia e Futbollit “L.” 387,000 lekë;
- ✓ Studentë 149,000 lekë;

**Totali 536,000 lekë**

- **Të tjera** më datë 31.12.2024, paraqiten në vlerën 6,966,653 lekë. Për vitet 2023-2024 për këtë llogari nuk ka shtesa apo pakësime. Sipas shënimeve shpeguese në pasqyrat financiare citohet se:

- a. **Kërkesa të Arkëtueshme Personeli** më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 2,824,020 lekë.

Kjo është shumë e mbartur nga viti 2017, e cila paraqet tërheqje nga banka por të pa dokumentuar me dokumentacion arke. Në Shoqëri mungojnë mandat arkëtimet dhe mandat pagesat si dhe dokumentat shoqërues që vërtetojnë shpenzimet e mundëshme të shumave të tërhequra nga banka.

- b. Debitorë kontrolli kërkesa të tjera** më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 553,526 lekë.

Kjo shumë paraqet detyrime të nxjerra me urdhër zhdëmtimi sipas auditimit të fundit të kryer në Shoqëri në vitin 2014.

- c. Kërkesa të arkëtueshme shpërblim dëmi** më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 3,589,107 lekë.

Kjo shumë paraqet detyrime të nxjerra nga auditi i realizuar në Shoqëri në vitin 2018.

- Në pasqyrën e Pozicionit Financiar më datë 31.12.2024, është kontabilizuar vlera prej 6,966,653 lekë si llogari të arkëtueshme. Shoqëria "Trajtimi i Studentëve" Gjirokastrë ka debitorë të pa mbledhur si ish-personel të ndërmarrjes të mbartur nga viti 2014, në bazë të akteve të kontrollit nga auditi i brendshëm si dëme financiare në vlerën 553,526 lekë; 2,824,020 lekë dhe 3,589,107 lekë të cilat ende nuk janë arkëtuar. Gjithashtu Shoqëria nuk disponohet një dokument për të cilën duhet të parashikonte riskun e mos arkëtimit nëpërmjet përlogaritjes së provizioneve (*zhvlerësim*), në zbatim të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 6, "Provizionet, pasivet dhe aktivet e kushtëzuara", pikat 10-11, i cili kërkon vlerësim individual për balancat e pa arkëtueshme në nivel individual si edhe në atë të përgjithshëm. Nga Shoqëria nuk është vendosur në dispozicion të grupit të auditimit një evidencë nëse ka ndjekur procedurat e mbledhjes së detyrimit pas proceseve gjyqësore të ndjekura. Këto veprime janë në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 6, "Provizionet, pasivet dhe aktivet e kushtëzuara", pikat 10-11, ku përcaktohet që:

*Pika 10: Njësia ekonomike do të njohë një provizion në bilanc kur:*

*(a) njësia ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv, si rezultat i ngjarjeve që kanë ndodhur para datës së bilancit;*

*(b) ekziston mundësia që për shlyerjen e detyrimit do të nevojitet një dalje e burimeve;*

*(c) mund të bëhet një vlerësim relativisht i saktë i shumës së detyrimit.*

*Pika 11: Njësia ekonomike do ta njohë një provizion në bilancin e saj vetëm kur e ashtuquajtura ngjarje detyruese ka ndodhur para datës së bilancit. Që një ngjarje të quhet detyruese, është e nevojshme që ajo të krijojë një detyrim ligjor ose konstruktiv për njësinë ekonomike, dhe që njësia ekonomike nuk ka asnjë alternativë tjetër për shmangien e këtij detyrimi, përveç shlyerjes së tij.*

### **Inventari**

- **Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme** më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 305,514 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 532,518 lekë me një rritje në vlerën 227,004 lekë.

Me shkresën nr. 518 prot., datë 29.12.2023, të Administratorit të Shoqërisë është ngritur komisioni për inventarimin e aktiveve të magazinës të Shoqërisë. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i sipërpërmendur është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën nr. 519 prot., datë 29.12.2023, për gjendjen e mëposhtme:

- Detergjentë 1,100 lekë;
- Hidraulike 40,736 lekë;
- Elektrike 233,714 lekë;
- Materiale ndërtimi 12,000 lekë;
- Kancelari 17,964 lekë;

**Totali 305,514 lekë**

Me shkresën nr. 904 prot., datë 30.12.2024, të Administratorit të Shoqërisë është ngritur komisioni për inventarimin e aktiveve të magazinës të Shoqërisë. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i sipërpërmendur është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën nr. 907 prot., datë 31.12.2024, për gjendjen e mëposhtme:

- Detergjentë 118,902 lekë;
- Hidraulike 97,900 lekë;
- Elektrike 217,636 lekë;
- Materiale ndërtimi 36,700 lekë;

- Kancelari 61,380 lekë;  
**Totali** 532,518 lekë

### Aktivitet Afatgjata Materiale

Shoqëria “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastër ka të pasqyruar në pasqyrat financiare më datë 31.12.2023, vlerën **800,001,423 lekë**, ndërsa më datë 31.12.2024, vlerën **798,597,764 lekë** me një pakësim në vlerën 1,403,659 lekë që i përket Aktiveve Afatgjata Materiale konkretisht:

**Ndërtesa** me vlerë neto më datë 31.12.2024, prej 786,894,208 lekë:

Zëri “*Ndërtesa*” më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 1,096,131,213 lekë kosto historike. Përgjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, por është përlllogaritur amortizim i akumuluar në vlerën 309,237,055 lekë dhe amortizim linear në vlerën 787,682 lekë. Të dhënat analitike të llogarisë paraqiten në tabelën si më poshtë:

Lekë								
Ndërtesa								
Nr.	Lloji i pasurisë	Zyra e regjistrimit	Zona Kadastrale Nr.	Numri i Pasurisë	Adresa e pasurisë	Sipërfaqja	Vlera kontabël	Vlera sipas regjistrimit
1	Ndërtesë	Gjirokastër	8...	2....	18-Shtatori	957	244,433,941	244,433,941
2	Ndërtesë	Gjirokastër	8...	2....	18-Shtatori	1015	851,697,272	851,697,272

**Tabela nr. 7.** Analiza e detajuar mbi gjendjen e zërit “*Ndërtesa*” më datë 31.12.2024.

**Ndërtime instalime dhe rregullime** me vlerë neto më datë 31.12.2024, prej 3,802,210 lekë:

Zëri “*Ndërtime instalime dhe rregullime*” më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 5,145,877 lekë kosto historike. Përgjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, por është përlllogaritur amortizim i akumuluar në vlerën 1,343,667 lekë dhe amortizim linear në vlerën 200,116 lekë.

**Makineri e Pajisje Kaldaja** me vlerë neto më datë 31.12.2024, prej 4,340,895 lekë:

Zëri “*Makineri e Pajisje Kaldaja*” më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 8,403,808 lekë kosto historike. Përgjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, por është përlllogaritur amortizim i akumuluar në vlerën 4,062,913 lekë dhe amortizim linear në vlerën 228,468 lekë.

**Instrumenta vegla pune** me vlerë neto më datë 31.12.2024, prej 117,258 lekë:

Zëri “*Instrumenta vegla pune*” më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 163,305 lekë kosto historike. Përgjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, por është përlllogaritur amortizim i akumuluar në vlerën 46,047 lekë dhe amortizim linear në vlerën 6,171 lekë.

**Mjete transporti** me vlerë neto më datë 31.12.2024, prej 429,672 lekë:

Zëri “*Mjete transporti*” më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 3,154,000 lekë kosto historike. Përgjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, por është përlllogaritur amortizim i akumuluar në vlerën 2,724,328 lekë dhe amortizim linear në vlerën 22,614 lekë. Të dhënat analitike të llogarisë paraqiten në tabelën si më poshtë:

Lekë									
Mjetet									
Nr.	Lloji i mjetit	Tipi/Markë	Targë	Leje qarkullimi	Kapaciteti	Vlera kontabël	Vlera e mjetit e regjistruar	Viti i prodhimit	Bara siguruar e mjetit
1	Autoveturë	T.	A.	-	-	960,000	960,000	2002	-
2	Autoveturë	M. B.	-	-	-	700,000	700,000	-	-
3	Xh..	L. R.	-	-	-	1,494,000	1,494,000	-	-

**Tabela nr. 8.** Analiza e detajuar mbi gjendjen e zërit “*Mjete transporti*” më datë 31.12.2024.

**Mobilje dhe pajisje zyre** me vlerë neto më datë 31.12.2024, prej 2,665,984 lekë:

Zëri “*Mobilje dhe pajisje zyre*” më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 21,353,584 lekë kosto historike. Përgjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, por është përlllogaritur amortizim i akumuluar në vlerën 18,687,600 lekë dhe amortizim linear në vlerën 140,315 lekë.

**Pajisje informatike** me vlerë neto më datë 31.12.2024, prej 347,538 lekë:

Zëri “Pajisje informatike” më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 944,166 lekë kosto historike. Përgjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, por është përlllogaritur amortizim i akumuluar në vlerën 596,628 lekë dhe amortizim linear në vlerën 18,291 lekë.

**Totali i Aktiveve për vitin 2023 në vlerën 811,011,200 lekë dhe për vitin 2024 në vlerën 814,192,240 lekë.**

Në Shënime Shpjeguese të pasqyrave financiare citohet se: “Në bilancin e vitit ushtrimor 2021, 2022, 2023 dhe 2024 nuk është paraqitur investimi që përfshin rikonstruksionin e godinës së Konviktit nr. 2. Investimi në formë donacioni nga A. T. “T..” ka filluar në muajin Nëntor të vitit 2019, dhe përfundoi në muajin Qershor të vitit 2020. Në institucion nuk është paraqitur asnjë lloj dokumenti që njofton fillimin e rikonstruksionit, apo dokumenta të tjera si: kontratë, dokument të marrjes në dorëzim të godinës së vjetër, situacion punimesh, fatura për vlerën e investimit, dokumenta për dorëzimin e këtij investimi të rikonstruktuar, vlera e pajisjeve, mobiljeve etj.,”.

- Gjendja e Pasqyrës së Pozicionit Financiar “Aktive Afatgjata Materiale” më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 798,597,764 lekë e cila përbëhet nga aktivet “Toka dhe ndërtesa” në vlerën 786,894,208 lekë, “Impiante dhe makineri” në vlerën 8,143,105 lekë dhe “Të tjera instalime dhe pajisje” në vlerën 3,560,452 lekë. Nga analiza e llogarive të aktiveve afatgjata materiale u konstatua se, Shoqëria “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastër nuk ka një regjistër analitik të aseteve me të dhënat specifike. Grupi i Auditimit konstatoi fizikisht që Godina e Konviktit është vendosur në restaurim dhe nga organet drejtuese deklarojnë se kjo godinë e ka përfunduar restaurimin, por dokumenta justifikues si kontrata, vendime bordi, fatura tatimore, situacione apo punime në proces, akt të marrjes në dorëzim të aktivitet apo Vendime të Këshillit Mbikqyrës mbi këtë investim në godinë shoqëria nuk i disponon. Shoqëria nuk disponon ekspertizë apo akt dorëzimi me listë aktivesh përpara vendosjes në restaurim të godinës aktuale të shoqërisë e cila ka kryer punimet, të cilat mund të jenë hequr nga godina e vjetër. Shoqëria nuk ka një listë aktivesh shoqëruar me inventar fizik dhe procesverbal në mbyllje të vitit ushtrimor 2024. Këto veprime janë në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet materiale dhe aktivitet afatgjata jo materiale” i përmirësuar, Kapitulli “Trajtimi kontabël për aktivet afatgjata materiale (AAM)”, pikat 8-10, ku përcaktohet që:

*Pika 8: Njësia ekonomike njeh koston e një zëri të AAM-ve si një aktiv nëse dhe vetëm nëse:*

*(a) aktivi kontrollohet nga njësia ekonomike;*

*(b) është e mundur që nga përdorimi i aktivitet do të hyjnë në njësinë ekonomike përfutime të ardhshme ekonomike;*

*(c) kosto e aktivitet mund të matet me besueshmëri.*

*Regjistrimi fillestar i AAM-së bëhet zakonisht në momentin e përfutimit të tij nga blerja apo prodhimi.*

*Pika 9: Pjesët e këmbimit, instrumentet dhe veglat e punës mbahen zakonisht si inventar dhe ngarkohen në shpenzime kur ato konsumohen. Megjithatë, pjesët kryesore të këmbimit dhe pajisjet rezervë janë aktive afatgjata materiale kur një njësi ekonomike pret për t'i përdorur ato gjatë më shumë se një periudhe. Në mënyrë të ngjashme, në qoftë se pjesët e këmbimit, instrumentet dhe veglat e punës mund të përdoren vetëm në lidhje me një zë të aktiveve afatgjata materiale, ato konsiderohen si aktive afatgjata materiale.*

*Pika 10: Toka dhe ndërtesat janë aktive të ndara dhe një njësi ekonomike do t'i trajtojë ato veç e veç edhe kur ato blihen së bashku.*

- Nga auditimi u konstatua se, Shoqëria “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastër gjatë hartimit të pasqyrave financiare ushtrimore për vitin 2024 nuk ka kryer përditësimet respektive mbi aplikimin e normave të amortizimit sa i takon aktiveve afatgjata materiale. Më poshtë paraqesim normat e aplikuar gjatë hartimit të bilancit për vitin 2024:

Nr.	Emërtimi i Aktivit	Amortizimi në % i aplikuar në vitin 2023	Amortizimi në % i aplikuar në vitin 2024
1	Ndërtesa	1%	1%
2	Ndërtime, instalime, rregullime	5	5
3	Makineri, pajisje-kaldaja	5%	5%
4	Instrumenta e vegla/pune	5	5
5	Mjete transporti	5%	5%
6	Mobileri dhe pajisje zyre	5	5
7	Pajisje informatike	5	5

**Tabela nr. 9.** Normat e aplikuara në pasqyrat financiare për vitet 2023-2024.

Referuar analizës së sipërcituar Shoqëria nuk ka aplikuar ndryshimet ligjore mbi përlllogaritjen e normave të amortizimit në zbatim të SKK nr. 5, “Aktivet materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale” i përmirësuar, Kapitulli “Trajtimi kontabël për aktivet afatgjata materiale (AAM)”, pikat 33-38, dhe Ligjin nr. 156/2014, datë 27.11.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar”, metoda e amortizimit mbi bazën e vleftës së mbetur ndërsa normat e amortizimit duhet të përdoren të njëjta me ato të sistemit fiskal në fuqi konkretisht:

- Ndërtesat deri në 5% mbi vlerën e mbetur;
- Mjetet e transportit deri në 20% të vlerës së mbetur;
- Makineri e pajisje deri në 20% të vlerës së mbetur;
- Pajisje informatike deri në 25% të vlerës së mbetur;
- Mobilje orendi, inventar ekonomik deri në 20% të vlerës së mbetur;
- Aktive afatgjata jomateriale deri në 15% të vlerës së mbetur.

Vlen të theksohet se, aplikimi i normave të amortizimit në pasqyrat financiare ushtrimore për vitet 2023-2024 është kryer pa marrë më parë, miratimin në Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë. Këto veprime janë në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 1, “Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”, pika 103, ku përcaktohet që:

*Pika 103. Disa të dhëna financiare, të paraqitura në pasqyrat financiare, bazohen në vlerësime të bëra nga drejtuesit e njësisë ekonomike, dhe jo në fakte të vëzhguara në mënyrë objektive. Shembuj të zbatimit të vlerësimeve kontabël janë:*

- a) vlerësimi i zhvlerësimeve për kërkesat e arkëtueshme dhe inventarëve;*
- b) vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale, si dhe përcaktimi i normave përkatëse të amortizimit;*
- c) krijimi i provizioneve për shitjet me garanci ose për mbulimin e kostove që lidhen me procedurat gjyqësore në proces.*

## **DETYRIMET DHE KAPITALI**

### **Detyrimet Afatshkurtra**

- **Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit (Furnitor)** më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 1,538,625 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 1,297,357 lekë me një pakësim në vlerën 241,268 lekë. Të dhënat në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqiten si më poshtë:
  - Furnitor kryesor OSHEE 1,159,382 lekë;
  - Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizime SHA 132,215 lekë;
  - Posta Shqiptare SHA 760 lekë;
  - Gj..... 5,000 lekë;
  - Totali 1,297,357 lekë**
- **TAP** më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 15,470 lekë ndërsa më 31.12.2024, në vlerën 38,202 lekë me një rritje në vlerën 22,732 lekë që i përket detyrimeve të muajit Dhjetor të vitit 2024.
- **Tatim në Burim** më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 10,704 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 35,863 lekë me një rritje në vlerën 25,159 lekë që i përket detyrime të muajit Dhjetor të vitit 2024.
- **Sigurime shoqërore dhe shëndetësore** më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 238,964 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 322,870 lekë me një rritje në vlerën 83,906 lekë që i përket detyrimeve të muajit Dhjetor të vitit 2024.
- **Efekte për t'u paguar siguracion i studentëve** më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 66,850 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, vlerën 87,850 lekë me një rritje në vlerën 21,000 lekë që i përket siguracioneve të studentëve të krijuara përgjatë viteve 2022-2024.

- **Detyrimet afatshkurtra më datë 31.12.2023, paraqiten në vlerën 2,503,915 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 2,032,382 lekë me një pakësim në vlerën 471,533 lekë.**

**Detyrimet Afatgjata** më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 31,892,876 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 31,285,449 lekë me një pakësim në vlerën 607,427 lekë.

Detyrime të mbartura ndaj FSHU në vlerën 31,189,475 lekë;

Detyrim për garanci difektsh për situacione punimesh OE "C." ShPK në vlerën 95,974 lekë.

### **Kapitali dhe rezervat për vitet 2023-2024**

	Lekë	
	2023	2024
✓ Kapitali Aksionar	727,244,000	727,244,000
✓ Rezerva rivlerësimi	105,828,637	105,828,637
✓ Humbje mbartur	- 57,038,690	- 56,458,228
✓ Fitim/Humbje e vitit ushtrimor	580,462	4,260,000

**Totali i Kapitalit për vitin 2023 është në vlerën 776,614,409 lekë ndërsa për vitin 2024 në vlerën 780,874,409 lekë**

**Totali i Pasivit për vitin 2023 është në vlerën 811,011,200 lekë ndërsa për vitin 2024 në vlerën 814,192,240 lekë**

#### ✓ **Procedurat për shpërndarjen e rezultatit financiar në Shoqëritë Aksionare:**

Në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Asambleja e Përgjithshme në cilësinë e Aksionarit të Vetëm të Shoqërisë (*Pronari*):

- *Miraton bilancin kontabël të Shoqërisë;*
- *Emëron ekspertin kontabël, të përgatisë raportin e zvogëlimit/zmadhit të kapitalit të Shoqërisë;*

Eksperti kontabël në zbatim të misionit të ngarkuar nga Asambleja, sistemon humbjen e mbartur (*Deri më datë 31.12.2024, në vlerën 56,458,228 lekë. Kjo situatë edhe pse për vitet ushtrimore 2023-2024 është pozitive, tregon se egzistojnë pasiguri thelbësore mbi aftësinë e shoqërisë për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë*) dhe fitimin me kapitalin e nënshkruar të shoqërisë në mbështetje të dokumentacioneve ligjore të vëna në dispozicion nga Shoqëria:

- Bilancin kontabël, ku pasqyrohet situata kontabël e Shoqërisë;
- Dokumentet ligjore shoqëruese;
- Urdhrin e Asamblesë së Përgjithshme në cilësinë e Aksionarit të Vetëm të Shoqërisë me vlerën përkatëse që do të zmadhojë apo zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë;

Në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, nenet 181-182 dhe 184-185, parashikohet se, Shoqëria, raportin e ekspertit për zvogëlimit/zmadhimin të kapitalit e miraton në Këshillin Mbikëqyrës dhe e dërgon për miratim në Asamblenë e Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme miraton procedurën e zvogëlimit/zmadhimin të kapitalit të Shoqërisë sipas vlerave përkatëse. Shoqëria pas miratimit të procedurave të zvogëlimit/zmadhimin të kapitalit të Shoqërisë me vlerën përkatëse nga Asambleja e Përgjithshme dhe e kontabilizon në llogaritë përkatëse në bilanc.

<b>PASQYRA E PERFORMANCËS (sipas natyrës)</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>
			<b>Lekë</b>
<b>Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit</b>			
<i>Të ardhurat nga aktiviteti kryesor</i>	4,608,818	5,020,650	3,735,000
<i>Të ardhurat nga aktiviteti dytësor 1</i>			
<i>Të ardhurat nga aktiviteti dytësor 2</i>	299,004		
<i>Të ardhurat nga aktiviteti dytësor 3</i>	219,000	5,001,922	3,711,181
<i>Të tjera të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>	8,759,020	13,100,000	18,000,000
<b>Të ardhura nga ndryshimi në inventarin e mallrave dhe prodhimit në proces</b>			
<b>Të ardhura nga puna e kryer nga njësia ekonomike për qëllimet e veta dhe e kapitalizuar</b>			
<b>Të ardhura të tjera të shfrytëzimit</b>			
<b>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</b>			
<i>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</i>	(2,540,640)	(276,880)	227,004
<i>Të tjera shpenzime</i>			
<b>Shpenzime te personelit</b>			
<i>Paga dhe shpërblime</i>	(6,964,868)	(12,907,411)	(12,174,663)
<i>Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore</i>	(2,700,475)	(2,561,636)	(2,428,596)
<i>Shpenzimet për pensionet</i>			
<b>Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale</b>			
<b>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</b>	(1,471,782)	(1,436,867)	(1,403,659)
<b>Shpenzime të tjera shfrytëzimi</b>	(4,842,836)	(5,349,507)	(5,402,859)
<b>Të ardhura të tjera</b>			
<i>Të ardhura nga njësitet ekonomike brenda grupit</i>			
<i>Të ardhura nga njësitet ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>			
<i>Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera në njësi ekonomike brenda grupit, pjesë e aktiveve afatgjata</i>			
<i>Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera në njësi ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse, pjesë e aktiveve afatgjata</i>			
<i>Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme nga njësi ekonomike brenda grupit</i>			
<i>Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme nga njësi ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>			
<b>Zhvlerësim i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra</b>			
<b>Shpenzime financiare</b>			
<i>Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme</i>			
<i>Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme për t'u paguar tek njësitet ekonomike brenda grupit</i>			
<i>Shpenzime të tjera financiare</i>	21,707	(9,809)	(3,408)
<b>Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga pjesëmarrjet të tjera (përshkruaj)</b>			
<b>Fitimi/(humbja) para tatimit</b>	<b>(4,613,053)</b>	<b>580,461</b>	<b>4,260,000</b>
<b>Tatimi mbi fitimin</b>			
<i>Tatimi mbi fitimin e periudhës</i>			
<i>Tatim fitimi i shtyrë</i>			
<i>Pjesa e tatim fitimit të pjesëmarrjeve</i>			
<b>Fitimi/(Humbja) e periudhës/vitit (A)</b>	<b>(4,613,053)</b>	<b>580,461</b>	<b>4,260,000</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për periudhën/vitit:</b>			
<i>Diferenca (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja</i>			
<i>Diferenca (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale</i>			
<i>Diferenca (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje</i>			

*Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet  
Të tjera (përshkrues)*

<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për periudhën/vitin (B)</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën/vitin (A+B)</b>	<b>(4,613,053)</b>	<b>580,461</b>	<b>4,260,000</b>

**Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për:**

Pronarët e njësisë ekonomike dhe me  
Interesat jo-kontrollues

Të ardhurat kanë ardhur kryesisht nga pagesat për akomodim nga studentët në rrjedhën normale të Shoqërisë. Në mënyrë analitike paraqesim pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve:

#### **Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit**

- Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit më datë 31.12.2023, paraqiten në vlerën 5,020,650 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 3,735,000 lekë;
- Të ardhura nga Aksioneri Kalim Energji më datë 31.12.2023, paraqiten në vlerën 884,530 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 674,924 lekë;
- Të ardhura nga A... (Pagesë paga + sigurime) më datë 31.12.2023, paraqiten në vlerën 4,117,392 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 3,036,257 lekë;
- Subvencione të shfrytëzimit më datë 31.12.2023, paraqiten në vlerën 13,100,000 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 18,000,000 lekë;
- Të ardhura nga interesa bankare më datë 31.12.2023, paraqiten në vlerën 37.60 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 175.95 lekë;

**Shpenzime për materiale e mallra** më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën (3,529,653) lekë:

- Blerje energji, ujë më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën (3,805,092) lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën (3,756,657) lekë;
- Lëndë të para materiale më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën (278,880) lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 276,880 lekë;

#### **Shpenzime të personelit**

- Paga dhe shpërblimet e personelit më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën (12,907,411) lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën (12,174,663) lekë;
- Sigurime shoqërore dhe shëndetësore më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën (2,551,636) lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën (2,428,596) lekë;

**Shpenzime konsumi dhe amortizimi** më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën (1,403,659) lekë:

- Amortizime të Aktiveve Afatgjata më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 1,436,867 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën (1,403,659) lekë;

**Shpenzime të tjera shfrytëzimi** më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën (1,586,579) lekë:

- Shpenzime personeli më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 330,000 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 512,273 lekë;
- Shpenzime shpërblime Këshilli më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 856,320 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 856,320 lekë;
- Shpenzime Posta + Interneti më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 65,140 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 62,590 lekë;
- Shpenzime për taksa dhe tarifa vendore më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 100,000 lekë po kështu edhe më datë 31.12.2024, në vlerën 100,000 lekë;
- Shpenzime tatime dhe taksa vjetore automjeti më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 14,586 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 13,986 lekë;
- Shpenzime të tjera (Analiza uji, paketë fiskalizimi etj.,) më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 10,100 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 22,100 lekë;

### Shpenzime financiare

- Shpenzime të panjohuara (*gjoba*) më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 121,916 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 14,008 lekë;
  - Shpenzime kamatvonesa më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 30,523 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 45,615 lekë;
  - Shpenzime të tjera financiare nga kursi i këmbimit më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 9,847 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 3,584 lekë;
- ✓ **Fitim/Humbja para tatimit për vitin 2023 është në vlerën 732,901 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 4,274,008 lekë**
- ✓ **Fitimi/Humbja e vitit për vitin 2023 është në vlerën 580,461 lekë ndërsa për vitin 2024 në vlerën 4,260,008 lekë**

### Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare

#### Fluksi i mjeteve monetare nga/përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit

	Lekë	
	2023	2024
Mjete monetare të arkëtuara nga klientët	4,622,453	3,499,416
Mjete monetare të arkëtuara nga subvencionet	13,100,000	18,000,000
Mjete monetare të arkëtuara nga granci Studentësh	66,850	43,000
Mjete monetare të arkëtuara të tjera interesa	37.60	175.9
Mjete monetare të kthyer studentëve	(108,333)	(22,000)
Mjete monetare të paguara ndaj furnitorëve	(3,659,786)	(4,103,464)
Mjete monetare të paguara ndaj punonjësve	(9,130,740)	(9,537,621)
Mjete monetare të paguara për sigurime shoqërore	(2,678,361)	(1,630,473)
Mjete monetare të paguara TAP punonjës	(174,702)	(235,495)
Mjete monetare të paguara për taksa vjetore Automjeti	(14,586)	(13,986)
Mjete monetare për shpërblim bordi	(727,872)	(788,528)
Mjete monetare për tatim në burim	(134,898)	(166,906)
Mjete monetare personel nga jashtë ekspert kontabël	(330,000)	(493,182)
Mjete monetare të paguara për taksa vendore	(100,000)	(100,000)
Mjete monetare të paguara për akt marrveshje Akt marrëveshje	0	(280,000)
Mjete monetare të paguara për komisione	(17,580)	(19,310)
Mjete monetare kamatë vonesa	(30,523)	(45,607)
Mjete monetare të paguara penalitetet, gjoba dëmshërblime	(121,916)	(14,008)
Mjete monetare Analiza uji, paketë fiskalizimi etj.)	(3,800)	(22,100)
Interes i paguar	0	(1,468)

- ✓ **Mjete monetare ekuivalente monetare** më datë 01.01.2023, paraqiten në vlerën 2,504,617 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, në vlerën 3,390,860 lekë
- ✓ **Mjete monetare ekuivalente monetare** më datë 01.01.2024, paraqiten në vlerën 3,390,860 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 7,599,304 lekë

**Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. I. M., z. I. M. Administratorë të Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastër për vitet 2023-2024 dhe znj. R. G. me detyrë Përgjegjës i Financës.**

## IV. REKOMANDIME

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Shoqëria “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastrë, për trajtimin e studentëve të Universitetit “Eqerem Çabej” me akomodim dhe shërbime të tjera, disponon në pronësi dy konvikte konkretisht:

Konvikti nr. 1, në të cilën akomodohen studentet vajza, organizohet dhe funksionon i ndarë në pesë godina me sipërfaqe bazë 1,005 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe totale të godinave 4,631 m<sup>2</sup>, me kapacitet akomodues 27 dhoma funksionale dhe numër maksimal shtretësh për 165 studentë, ku për herë të fundit është rikonstruktuar që prej vitit 2014, si dhe Konvikti nr. 2, në të cilën akomodohen studentët djem, i cili organizohet dhe funksionon me një godinë, me sipërfaqe bazë 961 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe totale të godinës 3,210 m<sup>2</sup> me kapacitet akomodues 51 dhoma funksionale dhe numër maksimal shtretësh për 127 studentë, ku për herë të fundit është rikonstruktuar në vitin 2021. Duke marrë në konsideratë faktin që për Konviktin nr. 1, investimet për përmirësimin e gjendjes infrastrukturore të godinave kanë datuar që prej vitit 2014, godinat kanë filluar të amortizohen duke paraqitur problematikë në suvatimin e mureve; sistemin elektrik; dyert; dritaret; sistemin sanitar etj. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 13-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandimi:** Administratori i Shoqërisë nëpërmjet Këshillit Mbikëqyrës të adresojë pranë Bashkisë Gjirokastrë si aksioneri i vetëm, një relacion të detajuar për sa i përket problematikave që lidhen me gjendjen aktuale të godinave të konvikteve, me qëllim parashikimin e fondeve në të ardhmen si pjesë e programeve ekonomike, për përmirësimin e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve optimale, me qëllim përmirësimin e jetesës së studentëve në këto ambiente.

*Në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi: a.** Nga analizimi i treguesve mbi realizimin e kapaciteteve akomoduese për trajtimin e studentëve u konstatua se:

- Me shkresën nr. 56 prot., datë 15.01.2025, nga Shoqëria është hartuar Raporti Përmbledhës mbi listën e studentëve për vitin akademik 2023-2024, ku totali i akomodimit shkon 93 studentë;

- Me shkresën nr. 1014 prot., datë 17.10.2025, nga Shoqëria është hartuar Raporti Përmbledhës mbi listën e studentëve për vitin akademik 2024-2025, ku totali i akomodimit shkon 71 studentë.

Nga auditimi u konstatua se, struktura organike nuk është përcaktuar saktë në zbatim të Udhëzimit nr. 7, datë 24.04.2003, “*Për kriteret e planifikimit dhe përdorimit të subvencionit buxhetor në ndërmarrjet e trajtimit të studentëve dhe ndërmarrjet e konvikteve dhe mensave të studentëve*”, pika 1, ku cilësohet se raporti i strukturës duhet të jetë 1 punonjës për 11 studentë, duke marrë në konsideratë faktin që për vitet 2023-2025 numri i punonjësve ka qenë respektivisht 22 punonjës për vitin 2023, 22 punonjës për vitin 2024 dhe 14 punonjës për vitin 2025. Nga komunikimet verbale me strukturat drejtuese të Shoqërisë, Lidhur me konstatimin e sipërpërmendur janë ngritur pretendimet se është e pamundur të respektohen kuotat punonjës për studentë referuar Udhëzimit nr. 7, datë 24.04.2003, “*Për kriteret e planifikimit dhe përdorimit të subvencionit buxhetor në ndërmarrjet e trajtimit të studentëve dhe ndërmarrjet e konvikteve dhe mensave të studentëve*” për arsytet e mëposhtme:

- Pamjaftueshmëria e likuiditeteve ndër vite.

Në shkresat mujore të alokimit të fondeve nga Ministria e Arsimit dhe Sportit citohet që shoqëritë do të subvencionohen në zbatim të VKM-së nr. 75, datë 12.02.2018, fondet e buxhetit të shtetit të miratuara në formë transferte për Shoqëritë të Trajtimit të Studentëve, kryen me urdhër të njësisë së qeverisjes së përgjithshme dhënëse me paraqitjen e dokumenteve justifikuese të shpenzimeve (*situacion, fatura, listëpagesa etj.*).

Subvencionimi i Shoqërisë “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastër nuk është kryer mbi bazën e dokumenteve justifikuese të dërguara bashkëlidhur me situacionet mujore, por referuar kritereve të parashikuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 7, datë 24.04.2003, duke krijuar gjithmonë “*ngërçin*” për subvencionimin e përvitshëm. Për këtë arsye ndër vite janë krijuar detyrime të prapambetura.

- Udhëzimi i lartpërmendur, ka dalë në zbatim të Ligjit nr. 8983, datë 20.12.2002, “*Për buxhetin e shtetit të vitit 2003*” dhe Udhëzimit nr. 6, date 30.01.2003, “*Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2003*” të cilat janë shfuqizuar;

- Udhëzimi është miratuar kur Trajtimet e Studenteve në vitin 2003, ishin institucione Ndërmarrje Shtetërore, ndërsa Shoqëri Aksionare është krijuar në vitin 2005;

- Nuk përshtatet me kushtet aktuale të zhvillimit ekonomik - financiar të vendit;

- Nuk përshtatet me ndryshimet e çmimeve (*të cilat kanë përsuar një ndryshim total që prej vitit 2003, në të cilin është miratuar udhëzimi*);

- Nuk përshtatet me Paktin e Universiteteve, Vendimit nr. 75, datë 12.02.2018, “*Për miratimin e modelit të financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor*”;

- Nuk përshtatet me mënyrën dhe organizimin e punëve në Shoqëritë e Trajtimit të Studentëve;

- Shërbimi që ofrojnë këto Shoqëri janë me përgjegjësi të lartë ndaj studentëve në plotësimin e kushteve të jetesës por dhe kujdesit ndaj tyre në çdo aspekt brenda territorit të Shoqërisë;

- Konvikti organizohet me tre turne në të cilën çdo turn ka strukturën sipas pozicioneve, përgjegjësive dhe nevojave. Për këtë arsye, stafi/punonjësit aktual është i organizuar dhe i përshtatur me 3 turne sipas Kodit të Punës;

- Ministria e Arsimit për tre vitet e fundit ka shprehur rezerva mbi programin ekonomik të zhvillimit, duke sugjeruar reduktimin e punonjësve të institucionit.

Nga analiza e përmendur më sipër evidentohet se, udhëzimi bie ndesh me mënyrën e organizimit real të punës, qëllimit kryesor të veprimtarisë në shërbim të akomodimit, të sigurisë e përgjegjësive që ka Shoqëria ndaj studentëve dhe prindërve për fëmijë përgjatë 24 orëve të ditës, në lidhje me përcaktimin e numrit të punonjësve për student;

**b.** Për sa i përket subvencionit që vjen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk shpërndahet në referencë të dokumentacionit justifikues të paraqitur nga Shoqëria (*kërkesa për disponibilitet fondesh*) në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” i ndryshuar, Kreu III “*Subvencionet*”, pikat 191-194, por në formën e një kuote mujore për përbalimin e pagave dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Referuar kthim përgjigjeve të mbi programin ekonomik zhvillimor, MAS shpreh rezerva për mos plotësimin me fondet e kërkuara nga Shoqëria, duke e sygjerruar reduktimin e numrit të punonjësve, me qëllim krijimin e fondeve për të mbuluar shpenzimet operative apo investimet. Gjithashtu lidhur për reduktimin e numrin të punonjësve MAS bazohet në përcaktimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 7, datë 24.04.2003. Në lidhje me këtë situatë grupi i auditimit ka arritur në konkluzionin se, për hartimin e programeve ekonomike zhvillimore nuk ka një bazë ligjore të mirë përcaktuar/konsoliduar, gjithë përfshirëse me elementët plotësues që duhet të ketë një program ekonomik. Për sa i përket Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 15, datë 02.05.2018, “*Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetërore*”, është një dispozitë ligjore e cila është aplikuar nga Shoqëritë e Trajtimit të Studentëve përgjatë fazës ku në rolin e Asamblesë së Përgjithshme Aksionare ka qenë Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe jo Bashkitë. Duke marrë në konsideratë faktin që numri i akomodimit të studentëve në konviktet e Shoqërisë ka një trend në rënie nga viti në vit, dhe e vetmja mënyrë që ky institucion të mos jetë në pamjaftueshmëri ekonomike si dhe të shmang humbjen, është mbulimi me kapacitet të plotë financiar në formën e subvencionit nga MAS dhe Bashkia Gjirokastër me qëllim realizimin e shërbimit me të gjithë

parametrat dhe kushtet që duhet të ketë Shoqëria “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastër. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 13-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Shoqëria “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastër në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të marrë masa për përshtatjen e bazës ligjore të subvencionimit me ndryshimet e krijuara pas riorganizimit të Shoqërisë.

*Në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Programet ekonomiko-financiare (*buxhetet vjetore*) janë hartuar dhe kryer në pamjaftueshmëri financiar pasi aktiviteti i shoqërisë nuk është i mbuluar në fakt plotësisht me buxhet duke marrë në konsideratë faktin që Shoqëria ka humbje të mbartur për tre vitet e fundit 2022 në vlerën 52,425,637 lekë; 2023 në vlerën 57,038,690 lekë dhe 2024 në vlerën 56,548,228 lekë, duke mos realizuar investimet dhe shpenzimet operative të parashikuara ndër vite për mirëmbajtjen e godina të konviteve duke krijuar risk të mund për nxjerrjen jashtë funksionit të tyre për shkak të amortizimit të lartë. Për më tepër evidentohet devijim i fondeve nga zëri “*Shpenzime operative*” në zërat “*Paga + Sigurime*” si pasojë e mos realizimit të plotë të të ardhurave të veta si dhe mos mbulimit me subvencion nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Bashkia Gjirokastër. Gjithashtu për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 30.10.2025, programet ekonomike-financiare zhvillimore janë miratuar vetëm nga Këshilli Mbikëqyrës por jo nga Asambleja Aksionare (*Bashkia Gjirokastër*). Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “*Për vetëqeverisjen vendore*”, neni 54, gërma “*dh*” dhe Statutin e Shoqërisë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 13-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës të merren masat që, programet ekonomike-financiare (*buxhetet vjetore*) të hartohen në mjaftueshmëri financiare, duke mbuluar me buxhet të gjithë aktivitetin e shoqërisë. Pas miratimit të programit ekonomik nga Këshilli Mbikëqyrës, praktika të adresohet pranë Asamblesë së Përgjithshme Aksionare (*Bashkia Gjirokastër*) në kohë për miratim së bashku me ndryshimet buxhetore gjatë vitit, si dhe të merren masa për zbatimin rigoroz të zërave të buxhetit, si për të ardhurat dhe shpenzimet, duke bërë analiza periodike dhe nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për devijimet nga programi i miratuar.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera me bankë u konstatua se, për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.10.2025, Shoqëria “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastër ka shpenzuar vlerën totale prej 671,114 lekë (*sipas likujdime pjesore mujore*) që i përkasin objektit “*Shpenzimeve Honorare*”.

- Me shkresën nr. 553 prot., datë 09.10.2024, Administratori i Shoqërisë është drejtuar Këshillit Mbikëqyrës me një relacion lidhur me nevojat emergjente të institucionit për marrjen në punë me kontratë shërbimi të punonjësve të jashtëm.

- Me Vendimin nr. 16, datë 09.10.2024, të Këshillit Mbikëqyrës me objekt “*Marrjen në punë të punonjësve me kontratë shërbimi*”. Për realizimin e këtij shërbimi sipas nevojës ndërmjet Shoqërisë dhe znj. B. K. është nënshkruar kontrata e shërbimit me nr. 568 prot., datë 09.10.2024, me afat një mujor e cila rinovohet sipas kërkesave të institucionit.

- Me shkresën nr. 853 prot., datë 19.12.2024, Administratori i Shoqërisë është drejtuar Këshillit Mbikëqyrës me një relacion lidhur me nevojat emergjente të institucionit për marrjen në punë me kontratë shërbimi të punonjësve të jashtëm.

- Me Vendimin nr. 21, datë 19.12.2024, të Këshillit Mbikëqyrës me objekt “*Marrjen në punë të punonjësve me kontratë shërbimi*”. Për realizimin e këtij shërbimi sipas nevojës ndërmjet Shoqërisë dhe znj. M. L. është nënshkruar kontrata e shërbimit me nr. 732 prot., datë 28.07.2025,

me afat një mujor e cila rinovohet sipas kërkesave të institucionit. Nga auditimi i kësaj praktike u konstatua se, ky shpenzim nuk i përket “Shpenzimeve Honorare” por një kontratë shërbimi dhe në këto kushte duhej t’i nënshtrohej rregullave të prokurimit publik. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenet 7-9, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 8. Aplikimi i kësaj ka ardhur si rezultat për mos tejkalimin e numrit të punonjësve për studentë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 19-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë të analizohet vlera prej 671,144 lekë që i përket shpenzimeve për kontratat e shërbimeve, për të cilat janë shmangur rregullat e prokurimit publik, duke mos i prokuruar ato. Të nxirren shkaqet dhe përgjegjësit përkatëse për mos përfshirjen në regjistrin e prokurimeve si shpenzimeve, me qëllim mos përsëitjen e rasteve të tilla në të ardhmen.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, struktura organizative dhe niveli i pagave të Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastër për periudhën objekt auditimi, nuk është miratuar specifikisht nga Asambleja e Përgjithshme Aksionare por vetëm nga Këshilli Mbikëqyrës konkretisht:

- Me Vendimin nr. 1, datë 17.02.2023, Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar strukturën organizative dhe nivelin e pagave të shoqërisë për vitin 2023 me një total prej 18 punonjës nga të cilët 4 punonjës të jashtëm me kontratë;

- Me Vendimin nr. 19, datë 29.12.2023, Këshilli i Mbikëqyrës ka miratuar strukturën organizative dhe nivelin e pagave të shoqërisë për vitin 2024 me një total prej 18 punonjës nga të cilët 4 punonjës të jashtëm me kontratë;

- Me Vendimin nr. 14, datë 16.09.2024, Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar strukturën organizative dhe nivelin e pagave të shoqërisë për vitin 2024 me një total prej 14 punonjës;

Organet drejtuese të Shoqërisë (Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori) e kanë quajtur të ezauruar miratimin vetëm me miratimin e programit ekonomik ku pjesë e tij është edhe fondi i pagave. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 35/2023, datë 25.05.2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitime të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, neni 6. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 21-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1. Rekomandimi:** Nga organet drejtuese të Shoqërisë të merren masat për miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave nga Asambleja e Përgjithshme Aksionare (Bashkia Gjirokastër), duke zbatuar në këtë mënyrë detyrimet ligjore dhe statutoore në mirëorganizimin dhe mirëfunksionimin e Shoqërisë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi, në pozicionin e Administratorit të Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastër, kanë qenë katër administratorë të emëruar në këtë detyrë sipas vendimeve respektive të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë me nr. 26-27, datë 20.03.2023, nr. 7, nr. 9, datë 14.07.2023, nr. 18, datë 10.12.2024, dhe nr. 19, datë 11.12.2025. Nga auditimi u konstatua se, për të katër Administratorët nuk është lidhur kontratë individuale pune me Këshillin Mbikëqyrës. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të një keq interpretimi të Statutit të Shoqërisë duke e konsideruar të ezauruar faktin e kontratës së punës nëpërmjet aktit të emërimit të administratorit, nga Asambledhja e Përgjithshme Aksionare. Këto veprime janë në kundërshtim me Statutin e Shoqërisë të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme Aksionare me shkresën nr. 5156

prot., datë 01.07.2020, neni 6, pika 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 21-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1. Rekomandimi:** Këshilli Mbikëqyrës në vijim dhe në zbatim të vendimmarrjes nga Asambleja e Përgjithshme Aksionare (*Bashkia Gjirokastrë*), të nënshkruaj kontratë me Administratorin e Shoqërisë, në të cilën të parashikohen kritere të qarta performance/objektiva që priten të arrihen në terma vjetorë, si dhe të bëhen vlerësime vjetore të performancës së punës së Administratorit, bazuar në objektivat/kriteret e performancës të parashikuar në kontratë.

*Në vijimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Pasqyrat financiare për periudhën e audituar (*vitet 2023-2024*) kanë marrë miratimin nga Asambleja e Përgjithshme Aksionare (*Bashkia Gjirokastrë*) respektivisht me Vendimet nr. 12, datë 10.06.2024, dhe nr. 14, datë 30.06.2024. Nga auditimi u konstatua se, pasqyrat financiare për vitet ushtrimore 2023-2024, nuk janë depozituar pranë Degës së Thesarit Gjirokastrë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 31, datë 23.12.2023, “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2023”, pika 35, dhe Udhëzimin nr. 13, datë 18.12.2024, “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2024”, pika 13. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 21-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1. Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë në bashkëpunim me Sektorin e Financës, në zbatim të akteve të dala nga Ministria e Financave lidhur me mbylljen e llogarive vjetore të buxhetit të shtetit, të merren masa duke depozituar edhe pranë degës së thesarit rajonale pasqyrat financiare vjetore.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**8. Gjetje nga auditimi:** Me Urdhrin nr. 518, datë 29.12.2023, dhe Urdhrin nr. 904, datë 30.12.2024, të Administratorit të Shoqërisë, janë ngritur komisionet për inventarizimin e aktiveve të magazinës së institucionit respektivisht për vitet 2023 dhe 2024. Në urdhrat e përmendur më sipër nuk janë përfshirë për inventarizim fizik zërat “*Toka dhe ndërtesa*”, “*Impiante dhe makineri*” dhe “*Të tjera instalime dhe pajisje*”. Në këto kushte, llogaritë e pasqyrave financiare nuk janë të rakorduar me gjendjen fizike, gjë e cila nuk krijon besueshmëri mbi vërtetësinë e tyre. Në këtë rast, nxjerrja e pasqyrave financiare pa kryer inventarizimin fizik e të gjithë aseteve, është shkelje e kërkesave të Udhëzimit nr. 30, datë 31.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 74. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 21-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Rekomandimi:** Administratori i Shoqërisë në bashkëpunim me Sektorin e Financës, të marrin masa për mbylljen e procesit të inventarizimit të aktiveve të veta për zërat “*Toka dhe ndërtesa*”, “*Impiante dhe makineri*” dhe “*Të tjera instalime dhe pajisje*” duke bërë dhe verifikimin në terren të këtyre aseteve. Për diferencat eventuale të konstatuara dhe për vlerat jashtë përdorimit nga inventarizimi, të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe të procedohet sipas ligjit për sistemimin e llogarive kontabël.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar më datë 31.12.2024, është kontabilizuar vlera prej 6,966,653 lekë si llogari të arkëtueshme e përbërë nga zëri “Kërkesa të arkëtueshme personeli” në vlerën 2,824,020 lekë. Shoqëria ka debitorë të pa mbledhur si ish-personel të ndërmarrjes të mbartur nga viti 2014, në bazë të akteve të kontrollit nga audit i brendshëm si dëme financiare në vlerën 553,526 lekë; 2,824,020 lekë dhe 3,589,107 lekë të cilat ende nuk janë arkëtuar. Gjithashtu Shoqëria nuk disponohet një dokument për të cilën duhet të

parashikonte riskun e mos arkëtimit nëpërmjet përlllogaritjes së provizioneve (*zhvlerësim*), në zbatim të SKK nr. 6, “*Provizionet, pasivet dhe aktivet e kushtëzuara*”, pikat 10-11, i cili kërkon vlerësim individual për balancat e pa arkëtueshme në nivel individual si edhe në atë të përgjithshëm. Nga Shoqëria nuk është vendosur në dispozicion të grupit të auditimit një evidencë nëse ka ndjekur procedurat e mbledhjes së detyrimit pas proceseve gjyqësore të ndjekura. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 21-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**9.1. Rekomandimi:** Administratori i Shoqërisë “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastër në bashkëpunim me Sektorin e Financës, të ndjek të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e debitorëve në vlerën 6,966,653 lekë, si dhe gjatë hartimit të pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore, të vlerësojë nëse ka evidenca të mjaftueshme objektive të zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe njohjet respektive në rezultatin ushtrimor.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**10. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e Pasqyrës së Pozicionit Financiar “*Aktive Afatgjata Materiale*” më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 798,597,764 lekë e cila përbëhet nga zërat “*Toka dhe ndërtesa*” në vlerën 786,894,208 lekë, “*Impiante dhe makineri*” në vlerën 8,143,105 lekë dhe “*Të tjera instalime dhe pajisje*” në vlerën 3,560,452 lekë. Në Shënimet Shpjeguese për pasqyrave financiare të vitit 2024 citohet se: “*Në bilancin e vitit ushtrimor 2021, 2022, 2023 dhe 2024 nuk është paraqitur investimi që përfshin rikonstruksionin e godinës së Konviktit nr. 2. Investimi në formë donacioni nga A. T. “T.” ka filluar në muajin Nëntor të vitit 2019, dhe përfundoi në muajin Qershor të vitit 2020. Në institucion nuk është paraqitur asnjë lloj dokumenti që njofton fillimin e rikonstruksionit, apo dokumenta të tjera si: kontratë, dokument të marrjes në dorëzim të godinës së vjetër, situacion punimesh, fatura për vlerën e investimit, dokumenta për dorëzimin e këtij investimi të rikonstruktuar, vlera e pajisjeve, mobiljeve etj.,*”. Në lidhje me këtë situatë u analizuan llogaritë e AAM-ve ku konstatohet se, Shoqëria nuk ka një regjistër analitik të asetëve me të dhënat specifike. Grupi i Auditimit konstatoi fizikisht që Godina e Konviktit është vendosur në restaurim dhe nga organet drejtuese deklarojnë se kjo godinë e ka përfunduar restaurimin, por dokumenta justifikues si kontrata, vendime bordi, fatura tatimore, situacione apo punime në proces, akt të marrjes në dorëzim të aktivitetit apo Vendime të Këshillit Mbikqyrës mbi këtë investim në godinë shoqëria nuk i disponon. Shoqëria nuk disponon ekspertizë apo akt dorëzimi me listë aktivesh përpara vendosjes në restaurim të godinës aktuale të shoqërisë e cila ka kryer punimet, të cilat mund të jenë hequr nga godina e vjetër. Gjithashtu nuk ka një listë aktivesh shoqëruar me inventar fizik dhe procesverbal në mbyllje të vitit ushtrimor 2024. Këto veprime janë në kundërshtim me SKK nr. 5, “*Aktivitet materiale dhe aktivitet afatgjata jo materiale*” i përmirësuar, pikat 8-10. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 21-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**10.1. Rekomandimi:** Organet drejtuese të Shoqërisë t’i adresohen Asamblesë së Përgjithshme Aksionare (*Bashkia Gjirokastër*) për ngritjen e një grupi pune me specialist të fushën për verifikimin e dokumentacionit tekniko-ligjor në Zyrën e Arkivit të institucionit në lidhje me investimin e realizuar prej vitit 2019 nga A. T. (T.). Në rast se dosja teknike është adresuar dhe marrë në dorëzim nga Shoqëria por nuk disponohet si praktikë, të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit ndaj personave përgjegjës, në të kundërt (*në rast se dosja nuk është adresuar pranë institucionit*) t’i adresohet Ministrisë së Financave në rolin e ish-Asamblesë, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Asamblesë aktuale Bashkisë Gjirokastër për vendosjen në dispozicion të dosjes teknike me qëllim pasqyrimin e të gjithave zërave të punimeve të realizuara nga ky investim, duke i kontabilizuar ato në bilanc dhe paraqitjen e një shtate të drejtë të aktiveve afatgjata materiale.

**10.2. Rekomandimi:** Nga Shoqëria “*Trajtimi i Studentëve*” Gjirokastër, Sektori i Financës të merren masa për hartimin e regjistrit të aktiveve që institucioni zotëron me të gjitha kërkesat e

formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimit të tyre.

*Në vijimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, Shoqëria “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastër gjatë hartimit të pasqyrave financiare ushtrimore për vitet 2023-2024 nuk ka kryer përditësimet respektive mbi aplikimin e normave të amortizimit sa i takon aktiveve afatgjata materiale, në zbatim të SKK nr. 5, “*Aktivet materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale*” i përmirësuar, pikat 33-38, dhe Ligjit nr. 156, datë 27.11.2014, “*Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”*” i ndryshuar. Për më tepër aplikimi i normave të amortizimit është kryer pa marrë më parë, miratimin në Këshillin Mbikëqyrës së Shoqërisë. Këto veprime janë në kundërshtim me SKK nr. 1, “*Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare*”, pika 103. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 21-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**11.1. Rekomandimi:** Nga strukturat drejtuese të Shoqërisë të merren masa për aprovimin e normave menaxheriale, të mbështetura këto në studime dhe vlerësime për jetëgjatësinë e aktiveve afatgjata materiale nga specialistët e fushës brenda limiteve ligjore.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

## **KONTROLI I LARTË I SHTETIT**